



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Hanns
Seidel
Stiftung

**MATJA E
DEMOKRACISË
SË BRENDSHME
TË PARTIVE
POLITIKE NË
SHQIPËRI**

**MATJA
E DEMOKRACISË
SË BRENDSHME
TË PARTIVE POLITIKE
NË SHQIPËRI**

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Tiranë, 2022

**Autore:**

Anjeza Xhaferaj

Këshilltar akademik:

Blendi Kajsiu

Hulumtuese:

Iliada Korçari

Analist i të dhënave:

Dior Angjeli

Redaktimi letrar dhe përkthimi:

Durim Tabaku

Arti grafik:

Eduart Cani

Tiranë, nëntor 2022

© Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H. 1, 1017
Tiranë, Shqipëri
Email: info@idmalbania.org
www.idmalbania.org

Ky botim u bë i mundur falë mbështetjes financiare të Fondacionit Hanns Seidel, Zyra për Shqipërinë. Përmbajtja dhe informacioni në këtë botim janë përgjegjësi vetëm e autores. Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Hanns Seidel.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	6
--------------------	----------

1. HYRJE	8
-----------------	----------

1.1 Pse ka rëndësi të studiohet DBP?	8
--------------------------------------	---

1.2 Pse duhet studiuar DBP në Shqipëri?	9
---	---

2. RISHIKIMI I LITERATURËS PËR DEMOKRACINË E BRENDSHME TË PARTIVE	12
--	-----------

2.1 Çfarë është demokraci të brendshme e partisë?	12
---	----

2.2 Faktorët që ndikojnë në demokracinë e brendshme	14
---	----

3. NJË HISTORI E SHKURTËR E PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE	20
---	-----------

4. MATJA E DEMOKRACISË SË BRENDSHME TË PARTIVE	25
---	-----------

4.1 Metodologjia dhe modeli teorik	25
------------------------------------	----

4.2 Analiza përmbajtjesore e statuteve të partive	33
---	----

4.3 Përfundime - Analiza përmbajtjesore	48
---	----

4.4 Analizë teksti - Si e kuptojnë anëtarët e të gjitha niveleve DBP dhe si e lidhin atë me jetën e tyre organizative?	50
--	----

4.5 Përfundime nga grupet e fokusuara dhe intervistat	70
---	----

5. PËRFUNDIME	75
----------------------	-----------

SHTOJCA

Shtojca 1. Diagrami i Demokracisë së brendshme në parti	78
---	----

Shtojca 2: Struktura e kategorive, nënkategorive dhe pyetjeve për secilën prej tyre	79
---	----

Shtojca 3. Pyetjet për fokus grupet	87
-------------------------------------	----

BIBLIOGRAFIA	88
---------------------	-----------

LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE:

DBP	Demokracia e Brendshme në Parti
LIBRA	Partia Lista e Barabartë
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
PAD	Partia Aleanca Demokratike
PBD	Partia Bindja Demokratike
PD	Partia Demokratike
PDD	Partia për Demokraci dhe Drejtësi
PDR	Partia Demokratike e Re
PL	Partia e Lirisë
PLN	Partia Lëvizja për Ndryshim
PS	Partia Socialiste
PSM	Partia Socialiste e Moderuar
PSV'91	Partia Socialiste e Vërtetë '91

LISTA E TABELAVE

TABELA 1: ROLI I ANËTARËVE DHE SHPËRNDARJA E PUSHTETIT TEK PARTITË POLITIKE SIPAS TIPOLOGJISË SË TYRE	16
TABELA 2: TË ARDHURAT FINANCIARE TË PARTIVE POLITIKE	21
TABELA 3: KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË PËR MATJEN E NIVELIT TË PËRFSHIRJES DHE DECENTRALIZIMIT TEK PARTITË POLITIKE	27
TABELA 4: LIDHJA E KATEGORIVE DHE NËNKATEGORIVE TË DBP-SË ME DIMENSIONET E DBP-SË	31
TABELA 5: NIVELI I DBP-SË PËR PS, PD DHE LSI	33
TABELA 6: PËRMBLEDHJE E DBP PËR PARTITË POLITIKE NË SHQIPËRI	34
TABELA 7: VLERAT E DBP-SË PËR KATEGORITË KRYESORE – PARTIA SOCIALISTE	34
TABELA 8: VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 2 – PARTIA SOCIALISTE	37
TABELA 9. VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 3 – PARTIA SOCIALISTE	39
TABELA 10: VLERAT E DBP-SË PËR KATEGORITË KRYESORE – PARTIA DEMOKRATIKE	40
TABELA 11: VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 2 – PARTIA DEMOKRATIKE	42
TABELA 12: VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 3 – PARTIA DEMOKRATIKE	44
TABELA 13: VLERAT E DBP-SË PËR KATEGORITË KRYESORE – LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM	45
TABELA 14: VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 2 – LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM	46
TABELA 15: VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 3 – LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM	47
TABELA 16: KRAHASIMI I GJITHËPËRFSHIRJES DHE DECENTRALIZIMIT TE PARTITË POLITIKE SHQIPTARE	49

PËRMBLEDHJE

Ky studim fokusohet në tri partitë politike kryesore në Shqipëri, Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim. Ai ka si objektiv të masë demokracinë e brendshme në parti (DBP) tek partitë politike në Shqipëri dhe të nxjerrë në pah si e kuptojnë anëtarët e partisë atë. DBP kuptohet dhe zërthehet në kategori dhe nën-kategori, në mënyrë që partitë në veçanti dhe të gjithë aktorët e interesuar në fushën e partive politike dhe demokracisë të mund të kuptojnë se në cilin komponent të DBP-së janë më mirë partitë dhe ku janë më keq. DBP matet në dy dimensione: gjithëpërfshirja dhe decentralizimi. Gjithëpërfshirja nënkupton sa mundësi dhe të drejta kanë anëtarët e partisë të shprehin mendimet e tyre dhe të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes. Me decentralizim kuptohet procesi i cili bën të mundur decentralizimin e procesit të vendimmarrjes nga niveli më i lartë i partisë në qendër në nivelet e seksioneve në bazë dhe tek anëtarët e partisë. Në një parti të decentralizuar, seksionet vendore të partisë gëzojnë një nivel të caktuar autonomie nga partia në qendër. Analiza bazohet në të dhëna parësore dhe dytësore. Analiza përmbajtësore e statuteve të partive fokusohet veçanërisht në matjen e DBP-së, ndërsa grupet e fokusuara me anëtarët e partisë dhe intervistat me zyrtarë të rangut të lartë të partive politike përdoren për të shqyrtuar rëndësinë dhe kuptueshmërinë që kanë anëtarët e partisë për DBP, si dhe për të vërtetuar gjetjet e analizës përmbajtësore. Gjetjet kryesore janë:

Analiza përmbajtësore e statuteve të partive:

Partitë kanë rregulla që rregullojnë jetën e tyre të brendshme. Gjithsesi, këto rregulla duhet të përmirësohen në mënyrë që të forcohet DBP. Problematike, në mënyrë të veçantë, ishin dispozitat për rolin e kryesisë dhe kryetarit të partisë, që u japin këtyre dy organeve, veçanërisht kryetarit të partisë, kompetenca për të mos i dhënë llogari anëtarëve të partisë dhe organeve të nivelit të mesëm. Për më tepër, anëtarët nuk ishin mjaftueshmërisht të përfshirë në procesin e emërimit të kandidatëve për deputetë, në zgjedhjen e kryesisë dhe këshillit kombëtar dhe në zgjedhjen e kryetarit të partisë. Nga ana tjetër, analiza konstaton se nuk ka procedura të mjaftueshme votimi për t'i bërë të mundur

anëtarëve të shprehin vullnetin e tyre dhe të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes dhe se anëtarët nuk pyeten ose pyeten fare pak për çështje programore. Analiza e marrëdhënieve ndërmjet qendrës dhe degëve të partisë nxori në pah se qendra e partisë ka akumuluar pushtet në dëm të degëve dhe se kjo e fundit gëzon shumë pak autonomi në procesin e vendimmarrjes.

Grupet e Fokusuara dhe Intervistat:

Studimi konstaton se anëtarët e partisë e lidhin demokracinë në nivel sistemi me DBP-në dhe se ata e kuptojnë shumë qartë DBP-në: çfarë është dhe si mund të arrihet ajo. Ata e lidhën DBP-në me strukturën dhe organizimin e partisë, duke e konsideruar strukturën organizative si një instrument të rëndësishëm që mundëson decentralizimin e pushtetit dhe përfshirjen e anëtarëve në procesin e vendimmarrjes. Anëtarët e partisë e konsideronin statutin si një instrument të rëndësishëm politik edukativ dhe i referoheshin atij sa herë që kishte mosmarrëveshje apo kur duhej të merreshin vendime. Ata e lidhnin DBP-në me sistemin zgjedhor dhe ishin të mendimit se lista e mbyllur proporcionale ishte një sistem që kishte forcuar pushtetin në duart e pakicave në nivelet e larta drejtuese të partisë dhe kishte dobësuar DBP-në.

1. HYRJJE

Demokracia e brendshme e partive (DBP) është një nga ato koncepte që përdoren shumë shpesh në arenën politike, por që rrallëherë zbatohen në praktikë. Janë një numër i madh studiuesish që kanë shkruar për aspektin normativ dhe kanë kryer analiza empirike për demokracinë e brendshme të partive (Cross & Katz, 2013; Scarrow, 2005; von dem Berge et al, 2013; Ware, 1979). Arsyeja e këtij interesimi për nivelin e DBP-së tek partitë politike buron nga fakti se këto të fundit konsiderohen si aktorë kryesorë të demokracive përfaqësuese moderne dhe luajnë një rol vendimtar në konsolidimin e sistemeve të reja demokratike. Partitë politike shërbejnë si institucione ndërmjetëse midis shtetit dhe shoqërisë dhe janë mekanizmi kryesor i agregimit të interesave dhe rekrutimit të kandidatëve, gjë që ka çuar në transformimin e tyre nga shoqatat tradicionalisht vullnetare drejt partive si një e mirë publike (van Biezen, 2004).

1.1 Pse ka rëndësi të studiohet DBP?

Partitë politike shërbejnë si institucione ndërmjetëse mes shoqërisë dhe qeverisë. Ato synojnë dhe përpiqen të përfaqësojnë dhe bëjnë bashkë interesat e grupeve të ndryshme të shoqërisë, të zhvillojnë dhe promovojnë politikëbërjen, të organizojnë zgjedhjen e kandidatëve, të prezantojnë tek elektorati alternativa konkrete politike për politikëbërjen, të sigurojnë shumica parlamentare si dhe të qeverisin (Hague dhe Harrop 2007 , fq 231–232; Poguntke 1998; Scarrow, 2005, f. 3). E gjithë kjo mund të ndodhë në një sistem shumëpartiak, në një sistem demokratik, ku partitë mund të konkurrojnë me njëra-tjetrën në një lojë të hapur dhe të ndershme ose duke përdorur shprehjen e famshme të Linz dhe Stepan (1996), në një sistem ku demokracia është “loja e vetme qytet.” Një nga kontributet kryesore që partitë mund t’i ofrojnë demokracisë është të japin alternativa të qarta dhe të dallueshme në mënyrë që votuesit të kenë ide të qarta se kujt do ia japin votën. Kur votuesit kanë alternativa të qarta, ata mund t’u kërkojnë llogari të zgjedhurve dhe më pas t’i “ndëshkojnë” në rast se këta të fundit nuk i mbajnë premtimet që kanë bërë. Në këtë skenar, strukturat e partisë gjykohen për kapacitetin që kanë për të mbështetur partinë në

procesin e politikëbërjes dhe në përzgjedhjen e personelit që duhet të pasqyrojë karakteristikat e elektoratit në përgjithësi (Scarrow, 2005, f. 4).

Harmel dhe Janda (1994, f. 265) e konsiderojnë demokracinë e brendshme të partive si një nga katër qëllimet kryesore të partive politike (maksimizimi i votave, maksimizimi i postit dhe mbrojtja e politikave/ideologjisë). Në të vërtetë, demokracia e brendshme e partive dhe marrëdhënia ndërmjet platformave politike dhe modeleve të organizimit të brendshëm të partive ushtrojnë një ndikim të rëndësishëm në mënyrën se si funksionojnë partitë (Kittilson dhe Scarrow 2003, f. 64). Tek partitë me nivele të larta të demokratizimit të brendshëm, ka më shumë shanse për të zgjedhur drejtues që janë më të aftë dhe që pëlqehen më shumë nga elektorati si dhe për të pasur politika që iu përgjigjen problemeve dhe nevojave të njerëzve (Scarrow, 2005, f. 3).

Kur partitë kanë demokraci të brendshme, ato sigurojnë që legjislatura të jetë e vëmendshme ndaj opinionit publik dhe garantojnë një "lidhje vertikale mes sferave të ndryshme deliberative dhe një lidhje horizontale mes çështjeve që konkurrojnë me njëra tjetrën" (Teorell, f. 363). Për më tepër, një parti me demokraci të brendshme ka më shumë gjasa të ndikojë pozitivisht dhe të forcojë kulturën demokratike në përgjithësi (Scarrow, 2005, f. 3). Partitë me demokraci të brendshme ndihmojnë në krijimin e qytetarëve të përgjegjshëm, duke kultivuar tek ata kompetenca politike, të cilat nga ana e tyre kontribuojnë në stabilitetin dhe legjitimitetin e demokracive në të cilat këto parti konkurrojnë për pushtet (Scarrow, 2005, f. 3). Kjo është arsyeja pse rivendosja dhe forcimi i lidhjeve të dobëta (në mos të shkëputura) me elektoratin dhe me anëtarët e partisë dhe aktivistët shihen si vendimtare nga shumë parti politike. Gauja (2017, f. 5) argumenton se reforma e organizimit të partive politike është bërë pjesë e një retorike më të gjerë të demokratizimit, riangazhimit dhe modernizimit që iu ofrohet audiencave të ndryshme – si të brendshme ashtu edhe të jashtme të partisë (në Borz dhe Janda, 2020, f. 5).

1.2 Pse duhet studiuar DBP në Shqipëri?

Studime të mëparshme për DBP-në në Shqipëri (Kajsiu, 2005; Krasniqi dhe Hackaj, 2013; Krasniqi, 2016) kanë vënë në dukje se partitë politike në Shqipëri vuajnë nga mungesa e demokracisë së brendshme. Kajsiu (2005) vë në dukje se "[në] qendër të krizave strukturore me të cilat përballen partitë politike shqiptare mbetet marrëdhënia mes qendrës

dhe bazës Të dy partitë politike [Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD)] janë shumë të centralizuara dhe vendimet më të rëndësishme merren nga një grup shumë i kufizuar njerëzish ose vetëm nga kryetari i partisë, shumë shpesh edhe kundër vullnetit të strukturave vendore të partisë ose në shkëlqje të hapur të statutit të partisë” (f. 147). Studimi vinte në dukje se anëtarët nuk ishin të kënaqur me përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë, kryesia e partisë rrallë konsultohej me strukturat në bazë dhe vendimmarrja ishte e centralizuar (Kajsiu, 2005). Mes gjetjeve për demokracinë e brendshme të partive politike në Shqipëri, Krasniqi (2016, f. 11; Krasniqi, 2017) vëren se partitë politike në vend nuk respektojnë statutin e tyre në aktivitetet që organizojnë, nuk janë transparente në vendimmarrje dhe praktikatat statutore të demokracisë së brendshme të partive vazhdojnë të jenë thjesht formale dhe se historia e vërtetë është e ndryshme nga ajo në letër. Partitë politike udhëhiqen nga “një elitë udhëheqësish të paprekshëm” që kontrollojnë partitë politike dhe [...] të gjithë sistemin politik si dhe proceset vendimmarrëse në Shqipëri (Krasniqi, 2017, fq. 26).

Demokracia e brendshme është bërë kohët e fundit një çështje e rëndësishme për partitë politike në Shqipëri. Konfliktet e brendshme në Partinë Demokratike (PD), pas humbjes së zgjedhjeve të vitit 2021, u bënë në emër të DBP-së. Ndryshimi i emrit nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) në Partia e Lirisë (PL) u bë sërish në emër të demokracisë së brendshme të partisë. Ndonëse nuk e përmend drejtpërsëdrejti, kreu i PS-së në takimet dhe fjalimet e tij me anëtarët e partisë flet për hapjen e partisë dhe përfshirjen e anëtarëve të saj në vendimmarrje, në formulimin e politikave dhe për të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në forumet partiake dhe në zgjedhjet parlamentare e ato vendore (Rama, 4 tetor 2020; Rama, 7 maj 2022). Të gjitha partitë krenohen me organizimin e zgjedhjeve partiake sipas parimit “një anëtar, një votë” dhe statuti i tyre ka një seksion kushtuar demokracisë së brendshme të partisë. I vërtetë apo i sajuar, ky nocion po zë një vend të veçantë në diskursin e drejtuesve të partive dhe përsëritet në të gjitha nivelet e organizimit të partisë nga lart poshtë. Është përdorur për të festuar fitoret ose për të rikuperuar forcat pas humbjes në zgjedhje. Konfliktet e brendshme brenda partive bëhen në emër të demokracisë së brendshme dhe koalicionet e partive bëhen dhe shpërbëhen në emër të saj.

DBP është e rëndësishme jo vetëm për shëndetin e partive politike por edhe për shëndetin e demokracisë shqiptare në përgjithësi. Prandaj, kjo demokraci e brendshme rekomandohet fuqishëm nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë si mënyrë për të forcuar demokratizimin.

Rrjedhimisht, mekanizmi “një anëtar, një votë” u prezantua në mes të viteve 2000 si praktikë për zgjedhjen e lidhshimit të partisë (Redford, 2004). Qëllimi i tij ishte të kontribuonte në decentralizimin e pushtetit brenda partive politike, në forcimin e lidhjeve ndërmjet udhëheqjes së partisë dhe anëtarëve, rritjen e llogaridhënies dhe përfshirjes së anëtarëve në procesin e vendimmarrjes.

Kanë kaluar mbi 30 vjet që nga rënia e regjimit komunist dhe vendosjes së demokracisë, ku sigurisht që dimë më shumë për DBP-në, por është ende e rëndësishme të kuptojmë dinamikën e brendshme të partive në lidhje me të. Për të pasur parti me demokraci të brendshme, është e nevojshme që partitë të kenë infrastrukturën, rregullat dhe procedurat që u mundësojnë atyre të jenë demokratike ku të gjithë, duke filluar nga anëtarë e thjeshtë e kderi te udhëheqja e partisë të janë të gatshëm të zbatojnë parimet e demokracisë brenda partisë së tyre.

Hulumtimet e kryera më parë për DBP-në te partitë politike në Shqipëri japin informacione mjaft të vlefshme, por që gjithsesi nuk matin demokracinë e brendshme në të gjitha dimensionet e saj. Prandaj, ato nuk arrijnë t’u ofrojnë partive politike rekomandime të qarta se ku duhet të përmirësohen. Studimet e marrin si të mirëqenë se statutet e partive ofrojnë një kuadër të konsoliduar për t’ua bërë të mundur partive të kenë një jetë demokratike. Megjithatë, siç tregohet edhe nga rezultatet e këtij studimi, kjo është larg së vërtetës. Për të përmirësuar DBP-në në praktikë, partitë duhet të përmirësojnë dispozitat që mundësojnë DBP edhe në statutet e tyre.

Ky studim synon të shqyrtojë dhe kuptojë nivelin e DBP-së së partive politike në Shqipëri. Për këtë, kemi analizuar përmbajtjen e statuteve të partive, kemi bërë intervista me drejtues të lartë të partive dhe kemi organizuar nëntë grupe të fokusuara (tre për secilën parti) me anëtarët e partisë.

Për këtë qëllim, studimi është i strukturuar në pesë kapituj. Në kreun e dytë bëhet një rishikim i literaturës dhe jepen reflektime për DBP. Ky kapitull i pasohet nga kapitulli metodologjisë së hulumtimit dhe identifikimit të metodave të nevojshme për ta realizuar atë si dhe për të ndihmuar në funksionalizimin e koncepteve që lidhen me DBP-në si dhe vetë DBP-në. Në kreun e katërt matet DBP e tre partive politike të marra në këtë studim. Në kreun i fundit jepen përfundimet e studimit si dhe ofrohen rekomandime për t’u zbatuar nga partitë politike nëse dëshirojnë të përmirësojnë nivelin e demokracisë së brendshme.

2. RISHIKIMI I LITERATURËS PËR DEMOKRACINË E BRENDSHME TË PARTIVE

Në veprën e tij kryesore “Partitë politike – Një studim sociologjik i tendencave oligarkike në demokracitë moderne”, Robert Michels (1911), pasi kreu një hulumtim të plotë të të gjitha praktikave të partive demokratike në Evropën Perëndimore në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të, arriti në përfundimin se demokracia e brendshme e partive nuk ishte e arritshme dhe një organizatë, çdo lloj organizatë është e destinuar të jetë oligarke. Sipas ligjit të hekurt të oligarkisë, formalizimi dhe burokratizimi janë të domosdoshëm për organizatat e mëdha dhe komplekse dhe ato përfundimisht i bëjnë partitë të kthehen në oligarki. Është e famshme shprehja e Michels: “Është organizata që i jep jetë sundimit të të zgjedhurve mbi zgjedhësit, të të mandatuarve mbi mandatorët, të delegatëve mbi deleguesit. Kush thotë organizatë, thotë oligarki” (f. 355). Më tej ai shton “Evolucioni historik tallet me të gjitha masat profilaktike që janë marrë për parandalimin e oligarkisë”. Kjo pikëpamje pesimiste ishte e vërtetë në kohën kur ai shkroi veprën, por a është ende e vërtetë edhe sot? Përpara se t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje, fillimisht do të sqarojmë disa koncepte rreth DBP-së, çfarë është ajo dhe cilët faktorë ndikojnë në të.

2.1 Çfarë është demokracia e brendëshme e partisë?

Çdo studim për një temë të caktuar kërkon para së gjithash përkufizimin e konceptit/ve të tij bazë. Prandaj, një studim për DBP-në do të bënte të nevojshme një përkufizim të vetë konceptit. Përndryshe, do të ishte e vështirë, në mos e pamundur, për të matur, kuptuar dhe shqyrtuar konceptin dhe zbatimin e tij në jetën e përditshme. Thënë kjo, dhënia e një përkufizimi përfundimtar për DBP-në është e vështirë dhe e debatueshme. Siç komentojnë edhe Cross dhe Katz (2013):

Ashtu si vetë demokracia, përkufizimi për DBP-në është në thelb i debatueshëm. A ka të bëjë ai kryesisht me pjesëmarrjen, gjithëpërfshirjen, centralizimin, llogaridhënien apo me diçka tjetër? A duhet të vihet theksi te rezultatet apo te procesi? Për shembull, nëse gjithëpërfshirja është aspekt kryesor, përsa i përket përzgjedhjes së kandidatëve, a qëndron problemi tek gjithëpërfshirja e elektoratit (ata që zgjedhin kandidatët), apo ka të bëjë më shumë me diversitetin e grupit të kandidatëve të përzgjedhur përfundimisht? Dhe, kë duhet të përfshijë secili nga këto grupe – anëtarët e partisë, mbështetësit e partisë në elektorat, apo elektoratin në përgjithësi? (f. 2)

Sipas von dem Berge et al (2013) "DBP në përgjithësi i referohet zbatimit të një grupi minimal normash brenda organizatave të partive politike. Në mënyrë ideale, në një parti demokratike vullneti duhet të vijë "nga poshtë-lart" dhe shpërndarja e brendshme e pushtetit duhet të karakterizohet nga shpërndarja në nivele, organe dhe individë të ndryshëm dhe jo nga përqendrimi në një organ të vetëm" (f. 2). Më pas autorët shtojnë se për të arritur një nivel të denjë të demokracisë së brendshme (çfarëdo që nënkuptohet me "të denjë") partitë duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të decentralizuara, të paktën në një masë të caktuar (f. 2). Këtë qasje e ndajnë edhe të tjerët, (Hazan dhe Rahat, 2006; Rahat dhe Hazan, 2001; Scarrow, 2005). Konceptet e gjithëpërfshirjes dhe decentralizimit shpjegohen gjerësisht në kreun e metodologjisë, por këtu mund të themi se gjithëpërfshirja nënkupton "masën që u lejohet individëve anëtarë të partisë për të shprehur mendimin e tyre ose për të marrë pjesë në vendimmarrjen brenda partisë" (f. 2) ose, siç argumenton Scarrow, gjithëpërfshirja tregon gjerësinë e rrethit vendimmarrës në një parti (2005, f. 6). Decentralizimi kuptohet si procesi që bën të mundur që "i gjithë procesi i vendimmarrjes të mos jetë i centralizuar në një organ në nivelin më të lartë kombëtar dhe që degët në nivel vendor të partisë të gëzojnë një nivel të caktuar autonomie" (f. 2).

Tek partitë me demokraci të brendshme, vullneti, politikat dhe strategjitë e partisë kanë një qasje "nga poshtë-lart" gjë që bën të mundur që shpërndarja e brendshme e pushtetit të ndodhë në të gjitha nivelet dhe degët e partisë dhe që pushteti të mos jetë i përqendruar në duart e udhëheqjes së partisë. Në partitë ekskluzive, vendimet më të rëndësishme, si emërimi i kandidatëve për deputetë, zgjedhja e drejtuesve dhe vendimet në lidhje me programin e partisë, merren dhe/ose kontrollohen nga kryetari i partisë ose një grup i vogël në kryesinë e partisë, dhe pjesa tjetër e anëtarëve të partisë nuk luajnë

ndonjë rol. E kundërta është e vërtetë për partitë gjithëpërfshirëse. Në partitë gjithëpërfshirëse, të gjithë anëtarët e partisë, e ndonjëherë edhe simpatizantët e partisë, kanë mundësinë të vendosin për çështje të rëndësishme partiake, si ato të përmendura më sipër.

Përfshirja është shumë e lidhur dhe varet nga rregullat dhe rregulloret formale të një partie. Partitë më gjithëpërfshirëse ofrojnë më shumë mundësi për diskutim të lirë dhe të hapur para fillimit të procesit të vendimmarrjes. Në partitë gjithëpërfshirëse (von dem Berge dhe Poguntke, 2017), pushteti është i decentralizuar nga qendra në të gjitha nivelet dhe nënivelet e strukturës së partisë, anëtarët kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes dhe udhëheqësit japin llogari para organeve të partisë si kongresi, apo edhe tek anëtarësia e përgjithëshme e partisë (f. 139). Në partitë me nivel të lartë centralizimi, këshilli drejtues mbledhet shpesh dhe ka autoritetin për të marrë vendime që pranohen nga pjesa tjetër e niveleve të partisë. Nga ana tjetër, në partitë e decentralizuara, këshilli kombëtar mbledhet rrallë dhe fokusohet më shumë në koordinimin dhe komunikimin sesa në ofrimin e udhëzimeve për organizimin e partisë (Scarrow, 2005, f. 6).

Megjithatë, Scarrow (2005) dhe Hazan dhe Rahat (2006) argumentojnë se partitë gjithëpërfshirëse nuk janë gjithmonë të decentralizuara dhe partitë e decentralizuara nuk janë gjithmonë gjithëpërfshirëse. Decentralizimi mund të ndodhë edhe kur kontrolli për emërimin e kandidatëve transferohet nga udhëheqja kombëtare në atë të bazës, duke rezultuar kështu në një parti përjashtuese (Hazan dhe Rahat, 2006, f. 112). Nga ana tjetër, partitë gjithëpërfshirëse, ku kryetari i partisë zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë nga anëtarët dhe jo nga delegatët e degëve në rrethe, bëhen të centralizuara, sepse minimizohet pushteti i degëve dhe nëndegëve të partisë (Scarrow, 2005).). Në fakt, drejtuesit e partive mund të nxisin përfshirjen e anëtarëve të thjeshtë, sepse ata e shohin atë si një mënyrë për të dobësuar fuqinë e drejtuesve rajonalë brenda partisë (f. 6).

Prandaj, në këtë studim, për të thënë që një parti ka demokraci të brendshme, është e nevojshme që partia të jetë sa gjithëpërfshirëse aq edhe e decentralizuar në një nivel të caktuar. Vetëm një dimension (gjithëpërfshirja apo decentralizimi), edhe pse kontribuon në demokracinë e brendshme të partisë, nuk garanton arritjen e saj.

2.2 Faktorët që ndikojnë në demokracinë e brendshme

2.2.1 Struktura organizative

Studimet shkencore për natyrën në ndryshim të organizimit të partive për shkak të ndryshimeve sociale dhe ekonomike të shoqërisë kanë treguar se partitë kanë humbur një pjesë të madhe të bazave të tyre ideologjike dhe janë shndërruar në organizata profesionale në kërkim të një performance më të mirë elektorale dhe në fund të fundit shërbejnë si mjete për qëllimin e marrjes së pushtetit nga udhëheqësit e tyre (Kirchheimer, 1966; Panebianco, 1988). Për të ruajtur pushtetin, partitë janë kthyer në organizata oligopoliste, të cilat kanë kufizuar aksesin e të aktorëve të jashtëm/partive të reja, duke reduktuar kështu alternativat politike që kanë në dispozicion (Katz dhe Mair, 1995). Kalimi i qendrës së gravitetit nga partia në bazë tek partia në qendër ka kontribuar në transferimin e vëmendjes së publikut te lideri i partisë dhe aftësitë dhe cilësitë e tij/saj personale. Poguntke dhe Webb (2005) e kanë etiketuar këtë si "presidencializimi i liderëve të partive" dhe i kanë emërtuar anëtarët si "nxitës tifozësh" (Schumacher dhe Giger, 2017, fq. 164).

Shndërrimi i organizatës së partisë nga "parti e masave" në parti "kap gjithkënd" dhe "kartel" ose "parti firmë biznesi" ka sjellë si rezultat "(1) rritje të dominimit të lidërshiptit të partisë, (2) ulje të jashtëzakonshme të numrit dhe ndikimi të anëtarësimit në parti, (3) dhe, forma oligopolistike të konkurrencës me partitë pa ideologji të qarta dhe rrjedhimisht një zhvlerësim të alternativave politike për elektoratin" (Schumacher dhe Giger, 2017, f. 165). Nga ana tjetër, Young (2013) pohon se "një numër i vogël partish të sapoformuara kanë arritur të kenë sukses në zgjidhje pa pasur një numër të madh anëtarësh, duke pohuar se demokracia zhvillohet në konkurrencën mes partive dhe jo brenda strukturave të organizatave të partive. Kufiri ndërmjet anëtarit të partisë dhe mbështetësit është zbehur shumë, ku kemi mbështetës që kryejnë shumë nga funksionet tradicionale të anëtarëve dhe – në disa raste – kanë fituar privilegjet që dikur i gëzonin ekskluzivisht vetëm anëtarët (f. 65).

Roli dhe rëndësia e anëtarëve në një parti, niveli i përfshirjes së tyre dhe procesi i decentralizimit ndryshojnë nga një tipologji partie në tjetrën (Carty, 2013; Hopkin dhe Paolucci, 1999; Katz dhe Mair, 1995; Katz, 2001; Panebianco, 1988; Scarrow, 2005; Young, 2013; van Biezen, 2004). Në tabelën e mëposhtme përmbledhet roli i anëtarëve, përfshirja e tyre dhe niveli i decentralizimit të vendimmarrjes në tipologji të ndryshme partish:

TABELA 1: ROLI I ANËTARËVE DHE SHPËRNDARJA E PUSHTETIT TEK PARTITË POLITIKE SIPAS TIPOLOGJISË SË TYRE

Tipologjia e partive	Përshkrimi	Anëtarët - Gjithëpërfshirja -Decentralizimi
Parti kuadrosh (Duverger, 1954)	- Mohon ekzistencën e anëtarëve	- Pak prova të një niveli të rëndësishëm të demokracisë së brendshme për çështje të politikës, personelit apo fondeve.
Parti e masave (Duverger, 1954)	- Anëtarët janë zemra e organizatës; - Partia organizohet në mënyrë hierarkike: partia në qendër me degë dhe nëndegë në të gjithë vendin.	- Pushteti organizativ përqendrohet tek partia në qendër, e cila menaxhon jetën elektorale dhe të anëtarëve të partisë; - Partia në qendër ndërmjetëson ndërmjet partisë në bazë dhe partisë në pushtet
Parti "kap gjithkënd" (Kirchheimer, 1966)	- Kërkon të zgjerojë thirrjen drejt një baze mbështetëse më të padiferencuar. - Deideologjizimi i jetës partiake; - I sheh anëtarët si partizanë për t'u manipuluar me qëllim që t'i japë legjitimitet kryesisë së partisë	- Parti e forcuar në poste publike dhe parti e dobësuar në bazë; - Zvogëlon rolin e individëve anëtarë të partisë; - Nuk ka struktura të decentralizuara; - Nuk ka vend për nivel të rëndësishëm të demokracisë së brendshme

Tipologjia e partive	Përshkrimi	Anëtarët - Gjithëpërfshirja -Decentralizimi
Parti elektorale - profesionale (Panebianco, 1988)	<ul style="list-style-type: none"> - Profesionalizimi i organizatës së partisë; - Mungesa e një përkufizimi të fortë ideologjik të jetës politike; - Roli qendror i ekspertëve dhe profesionistëve në çuarjen përpara të programit elektorale të partisë. 	<ul style="list-style-type: none"> - Dominimi nga kryesia e partisë; - Ekspertët dhe profesionistët i përgjigjen elitave që i punësojnë për detyra të caktuara dhe nuk i përgjigjen anëtarëve të partisë; - Anëtarët perceptohen si mbështetës për t'u shfrytëzuar dhe jo si qytetarë që marrin pjesë në organizata të qeverisura në mënyrë demokratike; - Roli me rëndësi të vogël për anëtarët e partisë.
<p>Parti karteli (Katz dhe Mair, 1995; Katz dhe Mair 2002)</p> <p>Parti karteli: Parti si ndërmarrje publike (van Biezen, 2004)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Politikanët profesionistë punësojnë ekspertë për të organizuar fushata elektorale me shuma të madha kapitale të përqendruara në mesazhe që premtojnë administrim efikas të aparatit shtetëror. - Partitë e kartelit varen nga subvencionet shtetërore që i çlirojnë nga mbështetja apo interesat e shoqërisë civile. 	<ul style="list-style-type: none"> - Triumfi organizativ i partisë në poste publike ndaj partisë në qendër dhe partisë në bazë; - Pak vend për dallime të mëdha partizane; - Anëtarët të caktuar rekrutohen për të mbështetur legjitimitetin e udhëheqjes dhe dallimi ndërmjet anëtarëve dhe mbështetësve është i paqartë; - Pjesëmarrja popullore është 'atomiste' me anëtarë ose përkrahës të izoluar nga njëri-tjetri dhe të angazhuar në komunikim të drejtpërdrejtë personal me qendrën e partisë; - Anëtarët e zakonshëm të partisë si vegla të kryetarëve; - Formulimi i proceseve vendimmarrëse në parti është armë e kontrollit nga elita; - Demokratizimi në letër mund të bashkëjetojë në praktikë me ndikimin e fuqishëm të elitës.

Tipologjia e partive	Përshkrimi	Anëtarët - Gjithëpërfshirja -Decentralizimi
Parti sipërmarrëse; Parti firmë biznesi; Parti karizmatike	- E lidhur ngushtë me personalitetin e liderit që mbikëqyr jetën e brendshme të partisë; - Modeli konkurrues i demokracisë në të cilin liderët konkurrojnë për votat e njerëzve për të marrë pushtetin për të vendosur;	- Lideri i partisë anëtarësimin i udhëheq anëtarët siç mobilizojnë pronarët e një firmë private fuqinë punëtore; - presidencializimi i pushtetit; - Partitë pa anëtarë
(Farell & Webb, 2000; Katz, 2006; van Biezen & Poguntke, 2014; Hopkin dhe Paolucci 1999; Paolucci, 2006)	- Perspektiva nga lart-poshtë e demokracisë.	- Retorika populiste: përjashtohen pjesëmarrja dhe diskutimi nga anëtarët; - Pak demokraci në parti; - Angazhimi në bazë i popullit konsiderohet si një kërcënim potencial për stabilitetin e sistemit politik

Burimi: Carty (2013). Tabela është hartuar nga autorja bazuar në materialin e Carty-t (2013)

Kuptohet gjerësisht se tipologjitë thjeshtojnë dhe e bëjnë më të lehtë mënyrën si e kuptojmë botën sot, por këto tipologji nuk gjenden në jetën reale në të njëjtën formë siç përshkruhen në teori. Në ditët e sotme, partitë shfaqin tipare të tipologjive të ndryshme. Nga tabela e mësipërme mund të shihet lehtësisht se është e vështirë të kesh parti me demokraci të brendshme. Duke qenë se ndryshimet organizative tek partitë politike kanë ndodhur për shkak të ndryshimeve në mjedisin social-ekonomik dhe politik ku veprojnë dhe funksionojnë partitë, ndryshimi i rolit të anëtarëve është i pashmangshëm. Por njohja e tipologjisë së partive në një vend ndihmon për të kuptuar pse partitë dështojnë të kenë demokraci të brendshme ose të kenë nivel të mjaftueshëm demokracie dhe si mund të trajtohet kjo.

2.2.2.a Niveli i institucionalizimit të partisë

Institucionalizimi i partisë është i lidhur edhe me strukturën dhe organizimin e saj. Koha kur partia vjen në jetë ndikon drejtpërdrejt në nivelin e institucionalizimit të saj dhe rrjedhimisht në burokracinë

dhe formalizimin e saj. Niveli i “institucionalizimit” të partisë përcaktohet nga shkalla në të cilën janë formalizuar procedurat e vendimmarrjes dhe shkalla në të cilën partia ka struktura koordinuese për elektoratin e synuar. Niveli i ulët i institucionalizimit është karakteristikë e partive të reja. Kjo ndodh pjesërisht, sepse duhet kohë për të ngritur struktura formale dhe një rrjet organizativ. Megjithatë, “partitë e vjetra” nuk janë gjithmonë të institucionalizuara. Partitë me një nivel të lartë të demokracisë së brendshme janë përgjithësisht shumë të institucionalizuara, sepse kanë nevojë për rregulla për të përcaktuar se kush ka të drejtë të marrë pjesë dhe çfarë nënkuptohet me fitore në garën e brendshme.

Është e rëndësishme të theksohet se nivelet e larta të institucionalizimit nuk janë domosdoshmërisht të barabarta me demokratizimin e brendshëm. Partitë politike jodemokratike dhe shumë të institucionalizuara janë më të vështira për t’u transformuar sesa ato që nuk e bazojnë funksionimin e tyre në rregulla dhe procedura. Megjithatë, nivelet e larta të institucionalizimit shihen si atribut pozitiv për stabilitetin politik të vendit: rregullat e brendshme ndihmojnë për të minimizuar konfliktet e brendshme dhe implikimet negative që mund të vijnë nga fraksionet, ose të paktën këto rregulla ndihmojnë në kanalizimin e konflikteve pa pasoja dhe mjaft shpesh ndihmojnë në një kalim të butë të pushtetit në parti. Edhe pse institucionalizimi konsiderohet si atribut pozitiv, është e vështirë të krijohet menjëherë, sepse është produkt i kohës. Partitë bëhen më të institucionalizuara me kalimin e kohës (Scarrows 2005, f. 6).

Tradita mund të jetë po aq e rëndësishme kur përcaktohen rolet dhe pozicionet e ndryshme brenda partisë. Si rregull, mbështetësit besnikë dhe të organizuar brenda partisë arrihen vetëm pasi të jenë mbajtur disa zgjedhje. Prandaj, nivel i lartë institucionalizimi nuk mund të imponohet menjëherë dhe në çast dhe është diçka që jo të gjithë liderët e partive duan ta promovojnë. Ata që duan të ndërtojnë struktura dhe besnikëri të qëndrueshme afatgjata mund të mbështesin anëtarët në formalizimin e rregullave, gjë që nga ana tjetër do të ndihmojë në transferimin e besnikërisë ndaj individit të besnikëria ndaj partisë, duke forcuar kështu institucionalizimin e partisë. Megjithatë, në partitë me nivel të ulët institucionalizimi shumë udhëheqës, veçanërisht ata që kanë pasuesit e tyre, mund ta shohin institucionalizimin si një kërcënim ndaj pushtetit të tyre personal (Scarrows 2005, f. 7).

3. NJË HISTORI E SHKURTËR E PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE

Sistemi partiak në Shqipëri u krijua pas rënies së regjimit komunist në dhjetor 1990. Tri partitë kryesore politike të analizuar në këtë studim janë Partia Socialiste e Shqipërisë (PSSH), Partia Demokratike e Shqipërisë (PDSH) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)¹. Të tre partitë kanë një strukturë organizative të ngjashme. Selia e partisë ndodhet në kryeqytet, në Tiranë. Këto parti kanë arritur të kenë një shtrirje të gjerë territoriale përmes degëve dhe celulave të tyre të shpërndara në të gjithë vendin. Partitë kanë rregulla formale për të regjistruar anëtarët e tyre dhe nuk është e vështirë të bëhesh anëtar ku të gjithë mund të aplikojnë. Numri i anëtarësimit është i lartë dhe shtrirja territoriale është e madhe, karakteristikë që i veçon ato nga partitë politike në vendet postkomuniste dhe në Evropën Perëndimore (Xhaferaj, 2018) ku nivelet e anëtarësimit kanë pësuar rënie. Edhe pse kontribuojnë shumë pak në aspektin e mbështetjes financiare (Tabela 2), anëtarët e partisë kanë rëndësi, sepse janë shumë të nevojshëm për organizimin e partisë në bazë.



1 Aktualisht LSI e ka ndryshuar emrin në Partia e Lirisë. Megjithatë, duke qenë se studimi analizon periudhën deri në ndryshimin e emrit, ne do të vazhdojmë të përdorim emrin e vjetër gjatë gjithë këtij studimi.

TABELA 2: TË ARDHURAT FINANCIARE TË PARTIVE POLITIKE

Partia	Kuotizacioni (Lekë/% e totalit të të ardhurave)	Financimi nga shteti (Lekë/% e totalit të të ardhurave)	Totali i të ardhurave (Lekë)
Viti 2020			
Partia Socialiste	3,976,235 (5.9%)	63,417,047 (94%)	67,393,282
Partia Demokratike	5,377,825 (12.1%)	38,911,877 (87.8%)	44,308,810
Lëvizja Socialiste për Integrim	2,913,700 (11.7%)	20,012,797 (82%)	24,949,403
Viti 2021			
Partia Socialiste	30,617,276 (19.2%)	127,689,608 (80%)	159,549,580
Partia Demokratike	10,782,310 (12.5%)	71,766,253 (83.2)	86,306,956
Lëvizja Socialiste për Integrim	2,199,860 (4.4%)	38,987,979 (77.3)	50,413,283

Burimi: Raporti financiar i vitit 2021 për PS, Raporti financiar i vitit 2021 për PD, Raporti financiar i vitit 2021 për LSI. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

TPartitë, veçanërisht PS dhe PD, e kanë ndryshuar statutin e tyre shumë shpesh dhe përgjithësisht pas zgjedhjeve apo në rastet kur ka patur debate për demokracinë e brendshme në parti. Kjo gjë shtjellohet më në thellësi në kreun ku analizohen statutet e partive. Megjithatë, mund të parashikojmë që ndryshimet e shpeshta janë tregues se statuti i partisë është i rëndësishëm dhe shërben si pikë referimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe menaxhimin e konflikteve në parti.

Dokumenti kryesor që përcakton dhe kërkon që partitë të kenë demokraci të brendshme është Ligji “Për partitë politike”. Konkretisht, Neni 7 parashikon që organizimi i brendshëm i partisë nuk duhet të jetë në kundërshtim me parimet demokratike. Për ta arritur këtë, partitë duhet të kenë një ndërtim nga poshtë lart, të organizojnë zgjedhje të

brendshme demokratike për forumet e partisë, të kenë të drejtën e shprehjes së mendimit për çdo anëtar, lirinë e hyrjes dhe e daljes së nga partia, si dhe të drejtën e çdo anëtari për të zgjedhur e për t'u zgjedhur (Ligji Nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike").

Partia Demokratike u themelua më 12 dhjetor 1990 si parti opozitare që sfidoi sistemin komunist dhe Partinë e Punës së Shqipërisë (partia e vetme gjatë sistemit komunist). Që atëherë, PD është pozicionuar si një nga dy partitë politike kryesore dhe më të mëdha në vend. Ajo fitoi zgjedhjet e viteve 1992, 1996, 2005 dhe 2009. Kur nuk ka fituar zgjedhjet, ajo ka qenë gjithmonë partia kryesore e opozitës. Ndonëse demokracia e brendshme në parti ka qenë përherë e pranishme në debatin zyrtar të partisë, mungesa e perceptuar e demokracisë në parti ka rezultuar në krijimin e partive të tjera si Partia Aleanca Demokratike (PAD) në vitin 1992 (vetëm disa muaj pas themelimit të PD-së dhe fitimit të zgjedhjeve), Partia për Demokraci dhe Drejtësi (1995), Rimëkëmbja Kombëtare (1995) Partia Demokratike e Re (PDR) në 2001 (Krasniqi, 2009, fq. 66-74), Fryma e Re Demokratike në 2012, Partia Bindja Demokratike në 2019 dhe Partia Lëvizja për Ndryshim në 2020. Kreu i PDR-së e cilësoi skenën politike në Shqipëri si diçka në krizë, një skenë ku politikanët kanë humbur lidhjet me popullin. Sipas tij, politikanët i kishin përqendruar të gjitha përpjekjet për të forcuar pushtetin e tyre dhe për të rritur përfitimet e tyre personale. Sipas Pollos, në një situatë të tillë partia ishte kapur nga një klan apo nga kryetari i partisë dhe mbështetësit e tij, të cilët ishin bërë bashkë për t'i shërbyer interesave të tyre dhe jo për hir të vlerave dhe ideve të përbashkëta (Pollo, 2004, f. 64-5, 7).

Si PAD ashtu edhe PDR u rreshtuan sërish me PD më vonë dhe deri diku kjo gjë ishte në përputhje me ndryshimet në statutin e partisë, e cila ka qenë shumë strikte për sa i përket ndërprerjes së anëtarësimit në dekadën e parë dhe më pas u zbut disi në dekadën e dytë duke treguar shenja tolerance ndaj atyre që kishin një mendim tjetër (Xhaferaj, 2018). Prezantimi i parimit "një anëtar, një votë" në procesin e zgjedhjeve të forumeve partiake vendore në 2007 është një tjetër tregues se partia po shkonte drejt një organizimi më demokratik (Redford 2004, f. 3). Në vitin 2005, kur PD fitoi zgjedhjet e përgjithshme në vend, demokracia e brendshme nuk ishte shumë në fokusin e drejtuesve të partisë. Ajo u bë problem në vitin 2013, pas humbjes së zgjedhjeve të përgjithshme dhe dorëheqjes së kryetarit dhe themeluesit të partisë. Dorëheqja shtroi problemin se kush do të ishte pasardhësi i themeluesit të partisë. Ky proces mobilizoi të gjithë anëtarët e partisë që u mblodhën rreth dy kandidatëve kryesorë dhe morën pjesë në garën brenda partisë, një element shumë i rëndësishëm i demokracisë së brendshme në parti.

Megjithatë, momenti më kritik i partisë, ai që mobilizoi anëtarët për më shumë se disa muaj dhe ka në qendër të saj konceptin e vetë demokracisë së brendshme, filloi në vitin 2021 pas humbjes së zgjedhjeve dhe që vazhdon ende sot e kësaj dite. Për momentin partia ka dy kryetarë. Janë dy PD, ajo zyrtare e njohur nga gjykata dhe ajo jozyrtare që ka nën kontroll zyrat dhe një pjesë të deputetëve në Kuvend. Humbja e zgjedhjeve dhe përjashtimi i ish-kreut të PD-së nga grupi parlamentar në shtator 2021, pas shpalljes së tij non-grata nga Departamenti Amerikan i Shtetit, shkaktoi debate të nxehta brenda partisë. Ish-lideri i partisë, Sali Berisha, nisi një fushatë të gjerë të quajtur “Foltore” duke bërë një turne në të gjithë vendin për të siguruar mbështetjen e anëtarëve. Në dhjetor 2021 por edhe më vonë u organizuan dy konventa, kongrese e konferenca. Debatet mes dy degëve/ndarjeve apo rrymave të partisë u lidhën përfundimisht me rolin e anëtarëve dhe se kush i përfaqëson më mirë ata. Kështu, demokracia e brendshme mori një aspekt shumë të rëndësishme në garën brenda partisë dhe u shndërrua në një fushëbetejë për pushtet.

Dy partitë e tjera, Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, janë të lidhura së bashku. Partia Socialiste Shqiptare është pasardhëse e Partisë së Punës së Shqipërisë (ish-Partia Komuniste) dhe si e tillë është shumë e konsoliduar, e institucionalizuar dhe me një organizim dhe prani shumë të mirë në të gjithë vendin. Demokracia e brendshme në parti ka qenë çështje diskutimi herë pas here dhe është shfaqur në mënyra të ndryshme në momente të ndryshme. Numri i partive të shkëputura prej saj është një tregues i kësaj. Ashtu si me PD-në, partitë si Partia Demokracia Sociale (PDS) në 2003, LSI (2004), Partia Socialiste e Vërtetë '91 (PSV91) (2009), Partia Socialiste e Moderuar (PSM) (2011) (Krasniqi, 2017, f. 16) dhe LIBRA në 2016 u krijuan nga PS dhe janë pasardhës të saj. Ndarja më e madhe ka qenë ajo që i dha jetë LSI-së. Sipas Ilir Metës, ish-kryetar i Forumit Rinor Socialist, Kryeministër i Shqipërisë dhe themelues i LSI-së, ai kishte pritur më kot të shihte materializimin e demokracisë brenda strukturave të PS-së (Meta 2004, 55). Kjo nuk ndodhi dhe, për këtë arsye, ai u largua. Në Kongresin e PS-së në vitin 2003, dy nga tre kandidatët për postin e kreut të partisë prezantuan në platformën e tyre politike nismën “Një anëtar, një votë”, duke e bërë atë partinë e parë politike shqiptare që propozonte një proces të tillë (Redford 2004, f. 2). Pas humbjes së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005, kalimi i pushtetit nga Fatos Nano (ish-kryetar i PS-së) tek Edi Rama (kreu aktual i PS-së) nuk ndodhi pa vështirësi. Megjithatë, ajo u arrit me sukses me mbështetjen e Gramoz Ruçit, i cili si Sekretar Organizativ i partisë bëri të mundur kalimin e besnikërisë nga ish-lideri i vjetër tek ai i ri.

Një tjetër ndarje e rëndësishme që erdhi si rezultat i mungesës së perceptuar të demokracisë brenda partisë në PS ka qenë krijimi i partisë tjetër, LIBRA, (Lista e Barabartë) në vitin 2016. Partia u krijua nga ish aleati i Edi Ramës, Ben Blushi, dhe u themelua si përgjigje ndaj mungesës së demokracisë së brendshme në Partinë Socialiste. Pas kësaj, zërat për mungesën e demokracisë së brendshme janë shuar dhe ata që kanë guxuar të dalin kundër kreut të partisë janë lënë jashtë.²

LSI është partia e parë politike në Shqipëri që futi në statutin e saj zgjedhjen e forumeve partiake sipas parimit ‘një anëtar, një votë’. E krijuar si nënndarje e PS, lideri themelues, Ilir Meta, mendonte se partitë me demokraci të brendshme ishin me rëndësi të jashtëzakonshme për nivelin e demokracisë në vend. Sipas tij, forcat politike drejtoreshin nga liderë “të përjetshëm”, të cilët nuk e konsideronin të rëndësishëm qytetarin e thjeshtë dhe anëtarët e partisë, por iu drejtoreshin atyre vetëm gjatë zgjedhjeve. Ai tha se LSI ka sanksionuar në statutin e saj që zgjedhjet brenda partisë të bëhen me parimin “një anëtar një votë”. Qëllimi i partisë së sapokrijuar ishte që ta çonte politikën te qytetari i thjeshtë, vendimmarrjen te publiku dhe të angazhonte aktivisht anëtarët në jetën e përditshme politike të partisë dhe në procesin e vendimmarrjes së saj. Kjo mendohej se do të kontribuonte në kohezionin social dhe integrimin e individit në një bashkësi vlerash dhe do të krijonte lidhje të forta materiale, morale dhe psikologjike mes qeveritarëve dhe të qeverisurve. Është e rëndësishme të theksohet se kreu i partisë u propozua dhe më pas u zgjodh President i Republikës së Shqipërisë nga Kuvendi në vitin 2017. Posti i kreut të partisë së Metës i kaloi përkohësisht njërit prej bashkëpunëtorëve të tij për t’iu dorëzuar bashkëshortes së Metës, Monika Kryemadhi, e cila ka qenë edhe kryetare e Forumit Rinor të Partisë Socialiste dhe më pas një nga figurat themeluese të LSI-së.

Siç shihet nga diskutimi më sipër, demokracia në parti ka qenë një problem i vazhdueshëm për partitë politike në Shqipëri. Udhëheqësit e partive kanë dështuar vazhdimisht në krijimin e mekanizmave që do të bënin të mundur që partitë të kishin demokraci të brendshme. Ndonëse kjo e fundit përdoret për të shkundur status quo-në brenda partisë, për të sfiduar postin e udhëheqjes dhe për t’u bërë fushëbetëje mes grupeve rivale në parti, ajo nuk ka dalë kurrë të fitojë terren brenda partive politike shqiptare.



2 Ditmir Bushati, ish Ministër i Jashtëm, u mënjana nga funksionet partiake dhe publike pasi filloi të mbajë një qëndrim kritik ndaj udhëheqjes së partisë.

4. MATJA E DEMOKRACISË SË BRENDSHME TË PARTIVE

4.1 Metodologjia dhe modeli teorik

Studimi synon të hedhë dritë mbi situatën aktuale të demokracisë së brendshme të partive politike shqiptare. Megjithatë, modeli analitik është i dobishëm për të matur nivelin e demokracisë edhe për periudhën e kaluar për aq kohë sa mund të gjurmojmë statutet e partisë. Ndonëse statutet e partive nuk e tregojnë të gjithë historinë e partisë, ato mund të na ofrojnë një pamje shumë të mirë të 'gjendjes shpirtërore' të partisë ndaj demokracisë së brendshme. Që nga fillimi i pluralizmit në Shqipëri, skena politike shqiptare është dominuar nga dy parti kryesore politike, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike. Në përgjithësi, sistemi partiak shqiptar ka qenë ose dypartiak ose sistem dypartiak e gjysmë (Xhaferaj, 2018). Kështu, partitë të marra në analizë janë Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim. Hulumentimi është mbështetur në korniza të ndryshme teorike, sepse qëllimi i hulumentimit kërkonte një kombinim të metodave gjatë vlerësimit të çështjeve të brendshme të partive. Niveli i demokracisë matet duke analizuar nivelin e përfshirjes dhe decentralizimit (von dem Berge et.al. 2013) përmes analizës përmbajtësore të statuteve të partive dhe analizës së intervistave të thëlluara me zyrtarë të lartë të partive politike dhe grupeve të fokusuara me anëtarë të partisë. Duke kombinuar të gjitha metodat u bë e mundur të matej niveli aktual i demokracisë së brendshme të partive politike dhe të evidentohet se si e kuptojnë dhe sa të rëndësishëm e konsiderojnë anëtarët dhe drejtuesit e partisë.

4.1.1 Analiza përmbajtësore e statuteve të partive

Von dem Berge et al (2013) propozojnë matjen e nivelit të DBP-së duke përdorur analizën përmbajtësore të statuteve të partisë. Autorët argumentojnë se edhe pse statutet e partive nuk garantojnë zbatimin e tyre, analiza e tyre është e dobishme për të kuptuar nivelin e përfshirjes

dhe decentralizimit dhe rrjedhimisht nivelin e demokracisë në çdo parti politike. Statutet e partive kanë një efekt socializues për aktorët që janë aktivë brenda institucioneve përkatëse. Është e vërtetë që, siç theksojnë Katz dhe Mair (1992), ekziston një dallim midis propagandës zyrtare dhe ngjarjeve aktuale që ndodhin brenda partisë dhe se propaganda mund të tregojë një parti që karakterizohet nga procedura demokratike, ndërsa ngjarjet aktuale mund të tregojnë një fytyrë tjetër. Megjithatë, statutet ofrojnë një “tregues të dobishëm të ndryshimit të qëndrimeve në lidhje me marrëdhëniet mes kryetarit të partisë, anëtarëve dhe organeve të partisë” (Kittilson dhe Scarrow 2003, f. 65). Për më tepër, në betejat e brendshme partiake shpesh përdoren rregullat formale dhe në këtë mënyrë evidentohen kufijtë e veprimit të ligjshëm në parti (Poguntke 2000). Madje edhe kur anashkalohen, rregullat janë sërish tregues shumë i mirë i atmosferës brenda partisë.

DBP në përgjithësi i referohet zbatimit të një grupi minimal normash brenda organizatave të partive politike (Zeuner 2003 në von dem Berge et.al., 2013), të cilat garantojnë se vullneti politik formohet “nga poshtë-lart” dhe se shpërndarja e brendshme e pushtetit bëhet në nivele, organe dhe individë të ndryshëm dhe nuk përqendrohet në një dorë të vetme. Pra, në partitë me demokraci të brendshme procesi i vendimmarrjes nuk është i centralizuar. Sipas von dem Berge et al, niveli i DBP-së matet duke analizuar nivelin e përfshirjes dhe decentralizimit në statutet e partisë.

Për të vlerësuar se sa gjithëpërfshirëse janë partitë dhe sa i decentralizuar është procesi i tyre i vendimmarrjes, kemi shqyrtuar tri dimensionet konceptuale të DBP-së: të drejtat e anëtarëve, strukturat organizative dhe vendimmarrja në përputhje me modelin e propozuar nga von dem Berge et al. (2013). Këto kategori kryesore ndahen në nën-kategor të tjera. Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e kuadrit konceptual të von dem Berge et.al.:

TABELA 3: KATEGORITË DHE NËNKATEGORITË PËR MATJEN E NIVELIT TË PËRFSHIRJES DHE DECENTRALIZIMIT TEK PARTITË POLITIKE

Main Category	Sub-category Level 1	Sub-Category Level 2	Sub-category Level 3
I. Të drejtat e anëtarëve	1.1 Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve		
	1.2 Të drejtat e pakicave		
II. Struktura organizative	II.1 Kongresi/Kuvendi i partisë		
	II.2 Organet për zgjidhjen e konflikteve		
	II.3 Asambleja/Këshilli Kombëtar		
	II.4 Kryesia e Partisë		
	II.5 Kryetari i partisë		
	II.6 Marrëdhëniet mes qendrës së partisë dhe degëve		

Main Category	Sub-category Level 1	Sub-Category Level 2	Sub-category Level 3
III. Vendimmarrja	III.1 Rekrutimi	III.1.1 Rekrutimi në postet publike në nivel kombëtar	III.1.1.1 Nominimi i kandidatëve
			III.1.1.2 Zgjedhja e kandidatëve për kuvend
			III.1.1.3 Përzgjedhja e kandidatëve për postin e kryetarit të partisë
			III.1.1.4 Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve për përzgjedhjen e kandidatëve
			III.1.2.1 Zgjedhja e Asamblesë/Këshillit Kombëtar
			III.1.2.2 Zgjedhja e Kryesisë
			III.1.2.3 Zgjedhja e kryetarit të partisë
			III.1.3 Procedures
			III.1.3.1 Procedurat e votimit
			III.1.3.2 Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve për përzgjedhjen e kandidatëve për poste publike në pushtetin lokal
III.1.3.3 Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve të partisë për përzgjedhjen e kandidatëve për kryesinë e partisë në degë			
III.2 Çështje programore			

Burimi: Von dem Berge et.al. 2013. Përshtatur nga autorja e këtij studimi

Kodimi i statuteve të partive është një proces shumë kompleks dhe modeli është zhvilluar nga Von dem Berge et al. (2013) për matjen e DBP-së tek partitë politike në vendet postkomuniste. Analiza përmbajtësore bën të mundur kuantifikimin e të dhënave të koduara dhe llogaritjen e DBP-së për çdo parti dhe në çdo kohë. Pra, na bën të mundur të krijojmë struktura kuptimore që krahasojmë partitë me njëra-tjetrën si dhe të krahasojmë demokratizimin e partisë (nëse ka) për gjatë kohës, që nga momenti i krijimit të saj deri në ditët e sotme. Statutet e partive janë shqyrtuar për të vlerësuar se si bëhet përzgjedhja e kandidatëve për deputet, nëse ekziston mundësia për zgjedhje të lira, të drejta dhe të rregullta brenda partisë dhe nëse ekziston mundësia për pjesëmarrje të barabartë dhe të hapur të të gjithë anëtarëve me qëllimin që interesat e të gjithëve të përfaqësohen në mënyrë të barabartë (Scarrow 2005, f. 7-20), si edhe nëse vullneti politik i partisë formohet nga anëtarët e partisë apo nga delegatët përmes zgjedhjeve të lira dhe nëse ka liri të fjalës dhe mbrojtje të pakicave (Von dem Berge et al., 2013).

Von dem Berge et al. (2013) ofrojnë një përshkrim shumë të hollësishëm të këtij procesi. Procedurat e kodimit janë inkuadruar me besnikëri në këtë studim dhe për më shumë hollësi se si bëhet kodimi është e nevojshme të konsultohemi me punën origjinale të autorëve. Megjithatë, për qartësinë e këtij studimi në këtë seksion po ofrojmë një shpjegim të shkurtër se si bëhet kodimi.

Në Tabelën 3 jepen kategoritë dhe nënkategoritë kryesore që do të maten. Sipas Von dem Berge et al:

Në procesin e kuantifikimit, çdo përgjigje (Po, Jo dhe Jo Specifikuar) për çdo pyetje i atribuohet vlera +1, -1, ose 0. Arsyeja për këtë përcaktim sasior është se të gjitha përgjigjet që kanë implikime negative në DBP në lidhje me dy aspektet e saj të dallueshme (d.m.th., gjithëpërfshirjen ose decentralizimin) i atribuohet vlera -1, pavarësisht nëse përgjigja është Po, Jo ose PP. Sipas të njëjtës logjikë, të gjitha përgjigjeve që kanë implikime pozitive në DBP u atribuohet vlera +1, pavarësisht nëse përgjigja është Po, Jo ose PP. Vlera 0 i jepet një përgjigjeje kur nuk mund të identifikohen efekte e veçanta në DBP. Skema e kodimit është hartuar në mënyrë të tillë ku përgjithet Po zakonisht kanë ndikim pozitiv për DBP-në (shembull përjashtimor është vetëm seksioni mbi prerogativat e kryetarit të partisë, kodi 25-21-0-0 deri në 25-25-0-0). Për më shumë detaje shih Shtojcën nr.2 (von dem Berge, 2013, fq.31).

Skema e kodimit është e përshtatur në mënyrë të atillë që përgjigjet 'Po' zakonisht kanë implikime pozitive për DBP-në e një partie politike (shembull për një përjashtim: prerogativat e kryetarit të partisë, kodet 25-21-0-0 për 25-25-0-0). Vendimet në lidhje me ndarjen e vlerave për

pikat (pyetje/përgjigje) bazohen në përkufizimet e secilës pyetje që janë dhënë në Shtojcën [2].

Duke ndjekur këtë logjikë, e vetmja herë kur përgjigja 'Po' është -1 është kur i referohet prerogativave të kryetarit të partisë, si më poshtë:

2.5 Kryetari i partisë (25-00-0-0)

• A i përmend statuti këto të drejta (detyrime) të kryetarit të partisë? (25-20-0-0)

...Të bllokojë ekzekutimin e vendimeve dhe akteve të tjera të kryesisë? (25-21-0-0)

...Të përjashtojë një anëtar partie? (25-22-0-0)

...Të shkarkojë një anëtar të kryesisë? (25-23-0-0)

...Të veprojë në kundërshtim me dispozitat e përgjithshme të statutit në raste të caktuara? (25-23-0-0)

...Të ngrejë apo mbyllë seksione vendore të partisë? (25-23-0-0)

Me të vërtetë, është e qartë se nëse kryetari i partisë ka të drejtë të bllokojë ekzekutimin, vendimet e akte të tjera të kryesisë, të përjashtojë anëtarët e partisë, të shkarkojë një anëtar të kryesisë së partisë, të veprojë në kundërshtim me dispozitat e përgjithshme të statutit dhe të ngrejë apo mbyllë seksione vendore, kjo do të ishte një situatë ku kryetari i partisë ka përqendruar pushtetin në duart e tij/saj në dëm të organeve të tjera të partisë dhe anëtarëve të partisë. Dhe kjo do të kontribuonte në dobësimin e DBP-së tek kjo parti.

Së fundi, për të llogaritur nivelin përfundimtar të DBP-së për çdo statut, vlerat e tre kategorive kryesore përmbledhen dhe pjesëtohen me numrin e kategorive kryesore (që është 3). Në këtë mënyrë, marrim vlerën përfundimtare të DBP-së për statutin përkatës, vlerë që varion nga -1 në +1.

Siç u përmend edhe më sipër, analizat përmbajtësore na siguronë informacion për nivelin e përfshirjes dhe të decentralizimit të partive politike në Shqipëri. Pas caktimit të vlerave si -1 ose 0 ose +1 tek kategoritë dhe nënkategoritë kryesore që jepen në Tabelën 3, është e mundur të kuptohet niveli i përfshirjes dhe decentralizimit për secilën parti. Në Tabelën 4 jepet se në cilin dimension të DBP-së (gjithëpërfshirja dhe decentralizimi) kontribuojnë kategoritë dhe nënkategoritë e identifikuar.

TABELA 4: LIDHJA E KATEGORIVE DHE NËNKATEGORIVE TË DBP-SË ME DIMENSIONIN E DBP-SË

Gjithëpërfshirja	Decentralizimi
<ul style="list-style-type: none"> • Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve • Të drejtat e pakicave • Kongresi/Kuvendi i Partisë • Organet për zgjidhjen e konflikteve • Asambleja/Këshilli Kombëtar • Kryesia • Kryetari i Partisë • Nominimi/kandidimi i kandidatëve • Përzgjedhja e kandidatëve për deputet • Zgjedhja e Asamblesë/Këshillit Kombëtar • Zgjedhja e Kryesisë • Zgjedhja e Kryetarit të Partisë • Procedurat e votimit 	<ul style="list-style-type: none"> • Kryetari i Partisë • Marrëdhënia mes qendrës dhe degëve • Nominimi/kandidimi i kandidatëve • Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve • Marrëdhëniet mes qendrës dhe bazës në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për poste publike të pushtetit vendor • Marrëdhëniet mes qendrës dhe bazës në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për kryesinë e degëve të partisë • Çështjet programore

Disa kategori dhe nën-kategori ofrojnë kuptueshmëri vetëm për një dimension dhe disa të tjera për të dy dimensionet. Me marrjen e rezultateve të statuteve të partive, mund të kuptojmë se ku janë partitë në secilin dimension dhe ku kanë mangësi e ku janë më mirë.

4.1.2 Analiza e intervistave dhe e grupeve të fokusuara

Për të mbështetur gjetjet e analizës përmbajtësore, autorja ka realizuar intervista me zyrtarë të lartë të partive dhe diskutime me grupe të fokusuara me anëtarë të partisë. Janë organizuar dhjetë intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të PS, PD dhe LSI. Intervistat u zhvilluan në periudhën korrik-shtator 2022. Organizimi i intervistave ishte veçanërisht i vështirë për shkak se shumë prej të kontaktuarve nuk iu përgjigjën ftesës për të shprehur mendimin e tyre.

Në mjediset e partive të marra në analizë u zhvilluan nëntë grupe të fokusuar, të cilat synonin mbledhjen e informacionit për perceptimet që kanë anëtarët për demokracinë e brendshme, çfarë procedurash ndiqen për ta mundur atë dhe cili ishte niveli i demokracisë së brendshme në partinë e tyre. Ndonëse është e rëndësishme të kuptohet se si e kuptojnë drejtuesit e partive demokracinë e brendshme, nuk është më pak e rëndësishme të kuptohet se si e mendojnë anëtarët e thjeshtë DBP-në. Në kreun e mësipërm, pamë se demokracia e brendshme përdorej nga drejtuesit e partive në betejat e brendshme për pushtet. Megjithatë, për të pasur sukses në betejat e tyre të brendshme, liderët kanë nevojë për mbështetjen e anëtarëve të partisë. Debati i nisur në hapësirën publike për publikun në përgjithësi (përfshirë këtu edhe anëtarët) si dhe brenda partisë në nivele të ndryshme të saj ka krijuar një realitet social të vërtetë për ata që e kanë përvetësuar atë. Siç thotë Gephart (2007, f. 7), debati është “një ansambël idesh, konceptesh dhe kategorish nëpërmjet të cilave u jepet kuptim fenomeneve shoqërore dhe fizike”. Siç u diskutua gjerësisht në kapitullin e parë, DBP nuk ka një kuptim të ngurtë. Ajo është rezultat i ndërveprimit dhe luftës për pushtet mes aktorëve politikë. Prandaj, ishte e nevojshme të intervistoheshin anëtarët e partisë për të parë nëse partitë e tyre siguronin parakushtet për një diskutim të thelluar, për të shqyrtuar se çfarë lloj mosmarrëveshesh lindin brenda partisë dhe si trajtohen ato.

Grupet e fokusuar u organizuan gjatë periudhës korrik-shtator 2022. Për secilën parti u organizuan tre grupe të fokusuar: një grup i fokusuar me anëtarët e partisë në përgjithësi, një grup i fokusuar me anëtarët e forumit rinor dhe një me anëtarët e forumit të gruas. Madhësia e grupit ndryshonte nga 5 deri në 11 pjesëmarrës. Realizimi i diskutimeve në grupe të fokusuar me të rinjtë dhe gratë, përveç atyre me anëtarët e tjerë, u konsiderua i rëndësishëm, sepse anëtarët brenda së njëjtës parti përballen me sfida të ndryshme politike sipas moshës dhe gjinisë së tyre. Kështu, përfshirja e tyre në diskutime bëri të mundur të kuptohet më mirë gjendja e DBP-së në partitë politike të marra në analizë, duke qenë se anëtarët ishin të përkushtuar politikisht dhe të angazhuar aktivisht në jetën e brendshme të partisë.

Diskutimet ishin gjysmë të strukturuar dhe zgjatën rreth një orë. Në fillim, pjesëmarrësit e grupeve të fokusuar u pyetën si e kuptojnë DBP-në, gjë që ua bëri më të lehtë angazhimin në diskutime. Më pas, ata u pyetën se sa mirë e njihnin statutin dhe sa shpesh i ishin referuar atij, çfarë mekanizmesh janë përdorur nga partia për të mbledhur mendimet e tyre, nëse janë konsultuar dhe përfshirë në procesin e vendimmarrjes, nëse janë konsultuar për programin dhe strategjinë e

partisë dhe përbërjen e listave të kandidatëve për deputetë në zgjedhjet parlamentare ose për kandidatë për kryetarë bashkish në zgjedhjet vendore. Pyetjet e tjera kishin të bënin me ekzistencën e fraksioneve brenda partisë – a ishin të mira apo jo dhe si duheshin menaxhuar ato, me barrën financiare me të cilën përballej partia për të funksionuar në mënyrë demokratike dhe me procesin e vendimmarrjes në kohë emergjencash.

4.2 Analiza përmbajtjesore e statuteve të partive

Në studim janë marrë në analizë 6 statute të PS-së (1999, 2000, 2003, 2011, 2015, dhe 2020), 8 statute të PD-së (1990, 1996, 1998, 1999, 2005, 2009, 2020) dhe dy statute të LSI-së (2009 dhe 2012). Për të matur nivelin e gjithëpërfshirjes dhe decentralizimit, autorët kanë dalluar tre kategori kryesore teorike për DBP-në: të drejtat e anëtarëve, strukturën organizative dhe vendimmarrjen, të cilat përcaktohen më tej duke krijuar nën-kategori të tjera siç është evidentuar në kreun e metodologjisë. Niveli i DBP varion nga -1 (niveli më i ulët i DBP) në +1 (niveli më i lartë i DBP).

Në tabelën e mëposhtme tregohet zhvillimi e DBP-së në partitë politike shqiptare. Mund të vërejmë se vlera e DBP-së luhetet përgjithësisht brenda të njëjtave vlera në të tria partitë, veçanërisht tek LSI-a.

TABELA 5: NIVELI I DBP-SË PËR PS, PD DHE LSI

Viti/ DBP	1990	1996	1998	1999	2000	2003	2005	2009	2011	2012	2015	2018	2020	2021
PS				0.53	0.51	0.55			0.42		0.45		0.43	
PD	0.30	0.29	0.34	0.28			0.37	0.36				0.30		0.32
LSI										0.47				0.47

TABELA 6: PËRMBLEDHJE E DBP PËR PARTITË POLITIKE NË SHQIPËRI

Parta	Vëzh-gime	Mes.	Min.	Maks.
Partia Socialiste e Shqipërisë	6	0.51	0.42	0.59
Partia Demokratike e Shqipërisë	8	0.33	0.28	0.37
Lëvizja Socialiste për Integrim	2	0.47	0.47	0.47

Megjithatë, për të kuptuar më mirë dinamikën e demokracisë së brendshme të partive dhe mënyrën se si shfaqet ajo në statutet e partisë, kemi marrë në analizë tre kategoritë kryesore: të drejtat e anëtarëve, struktura organizative dhe vendimmarrja, veçmas për çdo parti.

4.2.1 Analiza përmbajtjesore e Partisë Socialiste

Në Tabelën 7 tregohet se si tre komponentët e DBP-së, përkatësisht të drejtat e anëtarëve, struktura organizative dhe vendimmarrja, kanë ndryshuar nga njëri vit në tjetrin për Partinë Socialiste dhe si është prodhuar rezultati i kombinuar për DBP-në në përgjithësi. Mes tre kategorive, kategoria të drejtat e anëtarëve është më mirë se struktura organizative dhe vendimmarrja. E drejta e anëtarëve ka ecur mirë deri në vitin 2003 dhe më pas ka përjetuar një rënie të vazhdueshme, duke rënë në 0.58 në 2020. Tabelat e mëposhtme (7 dhe 8) hedhin dritë shtesë mbi dinamikën e tre kategorive.

TABELA 7: VLERAT E DBP-SË PËR KATEGORITË KRYESORE – PARTIA SOCIALISTE

	1999	2000	2003	2011	2015	2020	Viti	1999	2000	2003	2011	2015	2020
Të drejtat e anëtarëve	1	0.92	1	0.75	0.75	0.58	Demokracia e brendshme e partisë	0.53	0.51	0.59	0.42	0.45	0.43
Struktura organizative	0.3	0.3	0.46	0.32	0.36	0.42							
Vendim-marrja	0.29	0.31	0.31	0.19	0.24	0.28							

Tabela 8 shkon edhe më thellë për sa i përket niveleve dhe bën të mundur të kuptojmë më mirë secilën nga kategoritë kryesore. Kështu, mund të vërehet se në nënkategorinë të drejtat e anëtarëve, të drejtat e pakicave janë më mirë se të drejtat e anëtarëve, me përjashtim të vitit 2020, ku të drejtat e pakicave pësuan një rënie të konsiderueshme, nga 0.83 në 2015 në 0.33 në 2020. Kjo ka ndodhur për shkak të rënies së rolit të forumit rinor – aktualisht i shpërndarë dhe i organizuar vetëm në bazë. Kjo doli edhe gjatë diskutimeve të fokus grupit me të rinj, ku këta të fundit u ankuan për dobësimin e rolit që luanin në parti.

Për sa i përket strukturave organizative, të cila merren me strukturat formale brenda partisë dhe ndërveprimin e tyre (von dem Berge et al, 2013, f. 8), mund të vërehet se niveli i DBP-së është i dobët. Nga matja e komponentëve evidentohet se shpërndarja e pushtetit dhe e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme partiake shkon keq.

Kongresi i partisë: Sipas von dem Berge et al (2013), “[nëse] kompetencat e kongresit të partisë janë mjaftueshmërisht të mëdha, shpeshësia e seancave të tij duhet të tregojë një nivel të lartë të përfshirjes së anëtarëve në proceset e krijimit të opinionit dhe vendimmarrjes” (fq. 9). Duke marrë parasysh që nënkategoria ‘Kongresi i Partisë’ është një në vitin 2020 dhe ka pësuar një rritje të ndjeshme që nga viti 2003, mund të thuhet me siguri se kjo nënkategori kontribuon në përmirësimin e DBP-së brenda PS-së. Megjithatë, dhe kjo është shumë e rëndësishme të thuhet, nënkategoritë e tjera nuk janë mirë.

Organet e zgjidhjes së konflikteve: Nënkategoria e organeve të ‘zgjidhjes së konflikteve’ tregon aftësinë e partisë për t’i trajtuar anëtarët e saj në mënyrë të barabartë dhe ‘të vendosë sipas kërkesës për të gjithë anëtarët, përfshirë udhëheqjen e partisë, sa herë që sjellja e tyre dëmton partinë’ (Poguntke, 2005 në von dem Berge, 2013, f. 9). Në këtë nënkategori, PS-ja është në mes, duke treguar kështu se nuk janë marrë masat e duhura për t’i trajtuar të gjithë anëtarët në mënyrë të barabartë dhe për t’i dhënë atyre mbrojtje modeste ndaj masave disiplinore arbitrare të udhëheqjes së partisë.

Asambleja Kombëtare dhe Kryesia e Partisë: Këto janë dy organe vendimmarrëse të partisë. Në partitë me demokraci të brendshme, kompetencat ndahen në mënyrë të atillë që të bëhen pengesë ndaj udhëheqjes autokratike dhe që Kryesia të jetë e përgjegjshme dhe të kontrollohet nga kongresi i partisë (von dem Berge et al, 2013, f. 10). Të dyja nënkategoritë matin nivelin e përfshirjes së partisë. Siç tregohet edhe në tabelë, Asambleja dhe Kryesia e partisë kanë një nivel të lartë autonomie nga kongresi. Siç pohon von dem Berge et al (2013),

“ndarja mes Asamblesë dhe Kryesisë na mundëson të përcaktojmë se si shpërndahet pushteti brenda partisë dhe të evidentojmë dallimet mes niveleve të ndryshme organizative të partisë”. Në fakt, duke patur një nivel të lartë autonomie të Kryesie, nuk mund të flitet për shpërndarje të pushtetit mes niveleve. Duke qenë se kjo nënkategori mat nivelin e detyrimeve të këtyre organeve, sa llogari japin ato para kongresit të partisë dhe çfarë mekanizmash kontrolli janë vendosur për t’i kontrolluar ato (von dem Berge et al, 2013, f.10), mund të themi se niveli i gjithëpërfshirjes i matur nga kjo nënkategori është i ulët.

Kryetari i partisë: Nënkategoria ‘kryetari i partisë’ mat shkallën në të cilën drejtuesi i partisë ka prerogativa në lidhje me organet e tjera të partisë. Ajo përcakton shkallën e pushtetit të kryetarit siç parashikohet në statut. Nënkategoria tregon edhe nëse statuti ka vendosur mekanizma që mundësojnë sfidimin e kryetarit të partisë. Si rregull, sa më shumë prerogativa të ketë kryetari i partisë, aq më i ulët është niveli i përfshirjes dhe decentralizimit, pra aq më i ulët është niveli i DBP-së (von dem Berge et al, 2013, f.10-11). Vlera e nënkategorisë së Kryetarit të Partisë është 0.33 në të gjitha statutet e partisë, gjë që na ndihmon të kuptojmë se pozita e liderit të partisë është shumë e fortë, në parti nuk janë krijuar shumë mekanizma për të ndihmuar në sfidimin e pozitës së tij/saj dhe se kjo ka qenë konstante në të gjitha statutet e partive. Kjo përputhet shumë me historinë reale të PS-së. Kanë qenë vetëm dy kryetarë partie dhe ndryshimi ka ndodhur sepse kryetari i parë i partisë, Fatos Nano, dha dorëheqjen në vitin 2005 pas humbjes së zgjedhjeve të përgjithshme.

Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve të partisë: Kjo nënkategori mat nivelin e decentralizimit në marrëdhëniet mes qendrës dhe “periferisë”. Sa më e lartë të jetë vlera e kategorisë, aq më pak i centralizuar dhe më pak i përqendruar është pushteti në udhëheqjen e partisë (von dem Berge et al, 2013, f. 11). Tabela tregon se për momentin kjo vlerë është zero. Pra, roli i degëve është shumë i vogël, duke mundësuar kështu zyrtarisht përqëndrimin e pushtetit në duart e udhëheqjes së partisë. Kjo është vlera më e ulët në lidhje me këtë nënkategori. Dikur kjo vlerë ka qenë 0.75 në vitet 1999, 2000, 2003 dhe 2015. Më pas, ajo pësoi një rënie të madhe në 2011, pas zgjedhjeve vendore, që mund të kuptohet si efekti i “solidaritetit me kryetarin” pas humbjes së zgjedhjeve vendore në kryeqytet nga kreu i PS-së, një humbje që u perceptua si e padrejtë dhe si rezultat i manipulimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Partisë Demokratike. Ndonëse është e vështirë të kuptohet pse janë përkeqësuar aktualisht marrëdhëniet mes qendrës dhe bazës, është sigurisht një fushë ku partia duhet të përmirësohet.

TABELA 8: VLERAT E DBP PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 2 – PARTIA SOCIALISTE

Viti		1999	2000	2003	2011	2015	2020
Të drejtat e anëtarëve	Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve	1	0.83	1	0.67	0.67	0.83
	Të drejtat e pakicave	1	1	1	0.83	0.83	0.33
Struktura organizative	Kongresi i partisë	0.2	0.2	0.2	0.6	0.6	1
	Organet e zgjidhjes së konflikteve	0.5	0.5	0.5	0.75	0.5	0.5
	Asambleja e partisë	0	0	1	0	0	0.67
	Kryesia e partisë	0	0	0	0	0	0
	Kryetari i partisë	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33
	Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve	0.75	0.75	0.75	0.25	0.75	0
Vendimmarrja	Çështjet programore	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.55
	Rekrutimi	0.25	0.29	0.28	0.09	0.15	0.08

Vendimmarrja ndahet në dy nënkategori: Rekrutimi dhe Çështjet Programore.

Çështjet Programore: Kjo nënkategori tenton të përcaktojë se kush është përgjegjës për programin e partisë. Kur të gjithë anëtarët e partisë kanë mundësinë të votojnë për programin, kjo gjë është tregues se partia është gjithëpërfshirëse. Nga ana tjetër, kur lideri i partisë vendos për programin, partia është e mbyllur. Kur seksionet thonë fjalën e tyre

për programin e partisë, atëherë partia është gjithëpërfshirëse dhe anasjelltas. Të dhënat tregojnë se deri në vitin 2021, programi i partisë ka qenë kryesisht ekskluzivitet i kryesisë së partisë dhe vetëm në vitin 2021 partia është bërë më gjithëpërfshirëse në këtë dimension, edhe pse përmirësimi është i vogël.

Për sa i përket procesit të Rekrutimit, në Tabelën 9 jepen hollësi për nivelin e të kuptuarit dhe një shpjegim për rekrutimin dhe procedurat e tij. Rezultatet mund të shpjegohen si më poshtë:

Rekrutimi: Nënkatëgoria e Rekrutimit ofron informacione për rekrutimin për poste publike në nivel kombëtar, rekrutimi për poste partiake në qendër dhe procedurat e ndjekura në këto procese. Siç mund të vihet re, partia renditet shumë poshtë në këtë kategori. Kjo tregon se niveli i përfshirjes së anëtarëve të partisë në procesin e emërimit të kandidatëve, përzgjedhjes së kandidatëve dhe roli i seksioneve në emërimin e kandidatëve për poste publike kombëtare është i ulët. Pra, udhëheqja e partisë është e mbyllur dhe kontrollon procesin e emërimit dhe përzgjedhjes. E njëjta gjë vlen edhe për zgjedhjen e kryesisë dhe kryetarit të partisë. Udhëheqja e partisë ka kontroll të plotë për përzgjedhjen e Asamblesë Kombëtare dhe Kryesisë së Partisë. Kryetarin e partisë e zgjedhin kryesia dhe jo anëtarët. Prandaj, për këtë kategori partia është e mbyllur dhe e centralizuar.

Procedurat: Kjo nënkategori synon të përcaktojë nëse statuti ofron informacione për procedurat e votimit, të tilla si procedurat e votimit të fshehtë gjatë zgjedhjes së kryesisë së partisë ose kandidatëve për poste publike, ose të tilla si publikimi i rezultateve të zgjedhjeve tek anëtarët e partisë (von dem Berge et al, 2013, f. 14). Është e vetëkuptueshme që partitë që kanë votim të fshehtë janë më gjithëpërfshirëse dhe si rrjedhojë më demokratike, sepse rreziku i 'ndikimit tek votuesit nëpërmjet frikësimit ose ryshfetit është më i vogël në krahasim me procedurat e votimit të hapur, ku kundërshtimet mund të ndikojnë në linjën zyrtare të partisë" (von dem Berge et al, 2013, f. 14). Kjo nënkategori ka pësuar përkeqësim. Ajo ka qenë në kulmin e saj në vitet 2000 dhe 2003 dhe ka rënë në mënyrë drastike në vitin 2011. Prandaj, në këtë nënkategori partia ka kaluar nga gjithëpërfshirëse në përjashtuese, ku anëtarët e partisë nuk mund të shprehin plotësisht vullnetin e tyre për përzgjedhjen dhe zgjedhjen e kryesisë së partisë. Roli i seksioneve në përzgjedhjen e kandidatëve në poste partiake dhe publike është gjithashtu i vogël. Anëtarët kanë pasur më shumë pushtet deri në vitin 2003 në përzgjedhjen e kandidatëve të tyre për poste publike dhe partiake. Pushteti i tyre u ul ndjeshëm me miratimin e statutit të ri në

vitin 2011 dhe ka mbetur në nivele të ulëta (dhe ndonjëherë inekzistente) që prej atij viti. Kjo tregon një shkallë të lartë të centralizimit ku partia në qendër kontrollon pothuajse plotësisht zgjedhjen e kandidatëve për postet publike dhe partiake në nivel vendor.

TABELA 9. VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 3 – PARTIA SOCIALISTE

	Viti	1999	2000	2003	2011	2015	2020
Rekrutimi për poste publike kombëtare	Emërimi i kandidatëve	0.17	0.17	0.17	-0.5	0.33	-0.33
	Përzgjedhja e kandidatëve për deputet	0.2	0.2	0.2	0.5	0.2	0.2
	Roli i seksioneve	0.2	0.2	0.2	0	0.2	-0.2
Mesatarja e Rekrutimit për poste publike kombëtare		0.19	0.19	0.19	0	0.23	-0.11
Rekrutimi për poste partiake në nivel kombëtar	Zgjedhja e Asamblesë Kombëtare	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0
	Zgjedhja e Kryesisë	-0.2	0.2	-0.2	-0.2	-0.2	-0.2
	Zgjedhja e kryetarit të partisë	0.2	0.2	0.2	0.4	0.4	0.4
Mesatarja e rekrutimit për poste partiake në nivel kombëtar		0.07	0.2	0.07	0.13	0.13	0.07
Procedurat	Procedurat e votimit	0.5	1	1	0.25	0.25	0.25
	Roli i seksioneve (poste publike)	0	0	-0.25	-0.25	0	0.25
	Roli i seksioneve (poste partiake)	1	0.5	1	0	0	0.25
Mesatarja e vlerës së procedurave		0.5	0.5	0.58	0	0.08	0.25

4.2.2 Analiza përmbajtjesore e Partisë Demokratike

Tabela 10 tregon se ndër tre kategoritë kryesore, vendimmarrja është kategoria që vuan më shumë. Megjithatë, edhe dy kategoritë e tjera nuk dalin mirë. Për të kuptuar më mirë historinë përtej shifrave, është e nevojshme të futemi më thellë tek nën-nivelet, siç përshkruhet në metodologji. Logjika e analizave është e njëjtë me atë të ndjekur për Partinë Socialiste.

TABELA 10: VLERAT E DBP-SË PËR KATEGORITË KRYESORE – PARTIA DEMOKRATIKE

Viti	1990	1996	1998	1999	2005	2009	2018	2021
Të drejtat e anëtarëve	0.25	0.5	0.25	0.25	0.42	0.5	0.33	0.42
Struktura Organizative	0.37	0.32	0.51	0.32	0.40	0.33	0.33	0.33
Vendimmarrja	0.28	0.06	0.25	0.27	0.29	0.25	0.23	0.22

Tabela 11 jep informacion më të plotë për tre kategoritë më të rëndësishme: të drejtat e anëtarëve, struktura organizative dhe vendimmarrja.

Për sa i përket Të drejtave të anëtarëve, mund të shohim se të drejtat e përgjithshme të anëtarëve që si nënkategori është tregues i lirisë së mendimit dhe lirisë së fjalës, janë përkeqësuar gjatë periudhës së marrë në studim, ndërkohë që nënkategoria e të drejtave të pakicave, që i përket të drejtave të grave dhe të rinjve si dhe përfshirja e pakicave etnike, është përmirësuar dhe ka dalë mirë. Duke qenë se kategoria e të drejtave të anëtarëve është tregues i gjithëpërfshirjes së partisë ne mund të rekomandojmë që për ta përmirësuar atë, partia duhet të sigurojë lirinë e fjalës dhe lirinë e mendimit dhe të sigurojë mekanizma që 'mbështesin anëtarët me mendime të ndryshme nga opinioni i shumicës, të cilët duhet të ketë mundësi të mira për t'i prezantuar dhe diskutuar qëndrimet e tyre brenda partisë dhe në këtë mënyrë të përipiqen të krijojnë një shumicë alternative' (von dem Berge, 2013, f. 8).

Për sa i përket kategorisë Struktura Organizative, sipas metodologjisë, janë analizuar Kuvendi i Partisë, organet për zgjidhjen e konflikteve, Këshilli Kombëtar, Kryesia, Kryetari i Partisë dhe roli i seksioneve.

Analizat e statuteve të partisë nga viti 1990 deri në vitin 2021 tregojnë se:

Kuvendi i partisë: Nga këndvështrimi i DBP-së, duke qenë se Kuvendi i Partisë duhet të vendosë për çështjet statutore, programin e partisë dhe linjën e partisë, niveli i ulët i këtij treguesi tregon se në PD, roli i Kuvendit ka rënë që nga viti 2009 e deri më sot. Si pasojë, ka rënë edhe niveli i përfshirjes. Sipas von dem Berge et al (2013, “niveli i lartë i përfshirjeje shprehet përmes të drejtës së asambleve të anëtarëve dhe kuvendit të partisë për t’iu mbivendosur vendimeve të organeve të tjera (më pak përfshirëse, më të centralizuara)” (f. 8-9). Prandaj, rënia e rolit të kuvendit të partisë është tregues se organet e tjera (si p.sh kryetari) janë më të fuqishme.

Organet për zgjidhjen e konflikteve: Për sa i përket pranisë së organeve për zgjidhjen e konflikteve, me përjashtim të vitit 1998, asnjë organ e tillë nuk është ngritur në parti. Kjo tregon se partia nuk ka krijuar mekanizma që i mbrojnë anëtarët nga ndëshkimet arbitrare dhe disiplinore nga kryesia e partisë, në rast ka të tilla ndëshkime.

Këshilli Kombëtar dhe Kryesia: Të dy këto nënkategori janë shumë dobët. Duke qenë se ekzistenca e tyre është e rëndësishme për shpërndarjen e kompetencave në nivele të ndryshme brenda partisë dhe se ato duhet të përgjigjen para kuvendit të partisë, vlera e këtyre dy nënkategorive tregon se as pushteti nuk shpërndahet mes niveleve dhe se as organet nuk përgjigjen para anëtarëve të partisë. Kjo situatë është pothuajse e njëjtë me atë të Partisë Socialiste.

Kryetari i Partisë: Vlera e kësaj nënkategorie është e qëndrueshme në nivelin 0.33, që është e njëjtë me PS-në dhe, po ashtu si në PS, tregon se lideri i partisë ka mbledhur shumë pushtet dhe se i janë vendosur shumë pak kufij këtij pushteti. Edhe këtu (ashtu si në PS) nuk ka mekanizma që bëjnë të mundur të sfidohet posti i kryetarit të partisë. Historia e drejtuesve të partisë në PD e vërteton më së miri këtë, sepse ndryshimi i vetëm në drejtim ka ndodhur në vitin 2013, kur ish-kreu i PD-së Sali Berisha dha dorëheqjen pas humbjes së zgjedhjeve të përgjithshme të atij viti.³

Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve: Baza është nënkategoria që del më mirë se të gjitha. Rezultati me 0.75 është një tregues se kjo njësi është e rëndësishme në strukturën dhe organizimin e partisë si



3 Ndarja e Partisë Demokratike në fund të vitit 2021 ndodhi si pasojë e ngjarjeve që janë jashtë kategorisë së normalitetit.

dhe tregon se degët kanë aftësinë për t'u "dëgjuar në nivelin qendror të partisë" (von dem Berge et al, 2013, f.11).

TABELA 11: VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 2 – PARTIA DEMOKRATIKE

	Viti	1990	1996	1998	1999	2005	2009	2018	2021
Të drejtat e anëtarëve	Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve	0.67	0.5	0	0	0.33	0.33	0.17	0.17
	Të drejtat e pakicave	-0.17	0.5	0.5	0.5	0.5	0.67	0.5	0.67
Struktura Organizative	Kuvendi	0.8	0.6	0.8	0.6	0.8	0.4	0.4	0.4
	Organet e zgjidhjes së konflikteve	0.5	0.75	0.5	0.75	0.5	0.5	0.5	0.5
	Këshilli Kombëtar	0	0	0.33	0	0	0	0	0
	Kryesia	0	0	0.33	0	0	0	0	0
	Kryetari i partisë	0.17	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33
	Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve	0.75	0.25	0.75	0.25	0.75	0.75	0.75	0.75
Vendimarrja	Çështje programore	0.33	0.00	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33	0.33
	Rekrutimi	0.22	0.11	0.17	0.21	0.25	0.18	0.13	0.12

Procesi i Vendimarrjes është tregues i nivelit të përfshirjes së anëtarëve të partisë dhe seksioneve në hartimin e programit të partisë si dhe i roli që luajnë anëtarët e partisë dhe seksionet në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për parti dhe poste publike dhe në përzgjedhjen e kryetarit të partisë. Ky studim konstaton si më poshtë:

Çështjet programore: Situata këtu është e ngjashme me atë të Partisë Socialiste. Anëtarëve të partisë dhe njësive në bazë u lihet shumë pak hapësirë të thonë fjalën e tyre në hartimin e programit të partisë. Ky program është “vetë-pozicionimi zyrtar i partisë” (Budge et al, 2001 në von dem Berge et al, 2013, f.15). Duke qenë se anëtarët luajnë një rol të vogël në këtë drejtim, mund të themi se partia është pak gjithëpërfshirëse e anëtarëve të saj në hartimin e programit apo platformës së saj politike.

Nënkategoria Rekrutimi përcakton se çfarë roli luajnë anëtarët në përzgjedhjen e kandidatëve për poste publike dhe partiake si dhe në përzgjedhjen e kryesisë së partisë. Në Tabelën 12 jepet një panoramë sqaruese e procesit.

Të dhënat tregojnë se si Rekrutimi për Poste Publike në nivel kombëtar (p.sh. kandidatë për deputetë) ashtu edhe Rekrutimi për Poste Partiake në qendër nuk prezantohen mirë. Anëtarët nuk përfshihen ose përfshihen shumë pak në procesin e emërimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për deputet dhe organet e partisë. Kjo tregon se partia nuk është gjithëpërfshirëse dhe është e centralizuar në këtë kategori. Edhe shifrat për procedurat e votimit nuk janë të mira. Deri në vitin 2009 situata ishte e mirë, veçanërisht për rolin e degëve në përzgjedhjen e kandidatëve për organet e partisë. Pas vitit 2009, roli i degëve u dobësua edhe në këtë aspekt. Po kështu, ashtu si në rastin e PS-së, kërkua nëse statutet e partisë kishin dispozita për votimin e fshehtë në zgjedhjen e kryesisë së partisë dhe nëse kishin nene që detyronin kryesinë e partisë t’u vinte në dispozicion anëtarëve të partisë rezultatet e votimit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm ishte të shqyrtohej shkalla e pavarësisë së degëve në zgjedhjen e kandidatëve të drejtuar partinë në degë apo për të konkuruar poste publike në pushtetin lokal. Rezultati ishte se udhëheqja e partisë në qendër i kontrollon të dy këto procese duke i lënë pak (në mos aspak) autonomi seksioneve. Ky është tregues i një pushteti të centralizuar.

TABELA 12: VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 3 – PARTIA DEMOKRATIKE

Viti		1990	1996	1998	1999	2005	2009	2018	2021
Rekrutimi për poste publike kombëtare	Emërimi i kandidatëve	0.17	0.17	0.17	0	0	0.17	0.17	0.17
	Përzgjedhja e kandidatëve për deputet	0.2	0.2	0.25	0.2	0.2	0.2	0.17	0.2
	Roli i degëve	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0
Mesatarja		0.19	0.19	0.21	0.13	0.13	0.19	0.18	0.12
Rekrutimi për poste partiake në nivel kombëtar	Zgjedhja e Këshillit Kombëtar	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
	Zgjedhja e kryesisë	-0.2	-0.2	-0.2	-0.2	0.14	-0.2	-0.2	-0.2
	Zgjedhja e kryetarit të partisë	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.4	0.4
Mesatarja		0.07	0.07	0.07	0.07	0.18	0.07	0.13	0.13
Procedurat	Procedurat e votimit	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25	0.25
	Roli i degëve (poste publike në pushtet lokal)	0.5	0	0	0	0	0	0	0
	Roli i seksioneve (poste drejtuese partiake në degë)	0.5	0	0.5	1	1	0.5	0	0
	Mesatarja	0.42	0.08	0.25	0.42	0.42	0.25	0.08	0.08

4.2.3 Analiza përmbajtjesore për Lëvizjen Socialiste për Integrim

Analiza e LSI-së ka evidenca më pak të konsoliduara krahasuar me dy partitë e tjera. Autorja e këtij studimi i ka bazuar analizat në dy statute të

publikuara: atë të vitit 2012 dhe kjo e fundit e publikuar në faqen e LSI-së deri në momentin kur partia ndryshoi emrin e saj në "Partia e Lirisë". Megjithatë, dallimet ndërmjet dokumenteve kanë qenë shumë të pakta dhe për këtë arsye kategoritë dhe nënkategoritë kanë të njëjtat vlera siç tregohet në Tabelën 13. Rezultatet tregojnë se partia del më mirë dhe në fakt më mirë se dy partitë e tjera në kategorinë e të drejtave të anëtarëve.

TABELA 13: VLERAT E DBP-SË PËR KATEGORITË KRYESORE – LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

Viti	2012	2020	Year	2012	2020
Të drejtat e anëtarëve	0.83	0.83	Demokracia e brendshme në parti	0.47	0.47
Struktura Organizative	0.34	0.34			
Vendimmarrja	0.26	0.34			

Për sa i përket të drejtave të anëtarëve, partia del mirë si në të drejtat e përgjithshme të anëtarëve ashtu edhe në të drejtat e pakicave. Në fakt, statuti i partisë njih lirinë e mendimit dhe lirinë e fjalës dhe çka është më e rëndësishme statuti i partisë njih ekzistencën e fraksioneve brenda partisë. Po ashtu, shtrirja e të drejtave për grupet e pakicave, si gratë dhe të rinjtë, kontribuon në një nivel të mirë të gjithëpërfshirjes në parti.

Për sa i përket kategorisë "Struktura Organizative", LSI-ja del mirë në nënkategorinë "Kongresi i Partisë", marrëdhëniet mes qendrës dhe bazës dhe në nivel të moderuar në nënkategorinë e organeve për zgjidhjen e konflikteve.

Kuvendi i partisë: Nënkategoria e Kongresit të Partisë shënon 0.6, pak më e lartë se mesatarja 0.5. Ky është një tregues që Kuvendi i Partisë ka autoritetin (në një farë mase) të vendosë për çështjet statutoare, programin e partisë dhe linjën e partisë. Megjithatë, kjo duhet analizuar në dritën e nën-kategorive të tjera.

Organet për Zgjidhjen e Konflikteve: Vlera e nënkategorisë "Organet për Zgjidhjen e Konflikteve" është 0.5 që është një tregues se anëtarët nuk trajtohen në mënyrë të barabartë kur lindin mosmarrëveshje dhe se

gëzojnë mbrojtje të moderuar ndaj masave arbitrare dhe disiplinore të ushtruara nga udhëheqja e partisë.

Këshilli Kombëtar dhe Kryesia: Shifra e ulët në zero tregon se nuk ka mekanizma që sigurojnë llogaridhënien e këtyre organeve. Kur analizohet në lidhje me nënkategoritë:

Kryetari i partisë: në shifrën 0.17 tregon se Kryetari i Partisë është me të vërtetë i fuqishëm dhe kontrollon partinë. Del qartë se edhe pse Kuvendi i Partisë ka një pozicion të rëndësishëm në jetën e partisë, Kuvendi sërish nuk i mban llogaridhënës as kryesinë dhe as kryetarin e partisë.

Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve: kjo kategori tregon se decentralizimi në marrëdhëniet ndërmjet nivelit kombëtar dhe atij lokal ndodh vërtet. Seksionet përmenden në statut dhe gëzojnë të drejta të rëndësishme në nivele të ndryshme organizative.

TABELA 14: VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 2 - LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

		Viti	2012	2020
Të drejtat e anëtarëve	Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve		1	1
	Të drejtat e pakicave		0.67	0.67
Struktura Organizative	Kuvendi i partisë		0.6	0.6
	Organet e zgjidhjes së konflikteve		0.5	0.5
	Komiteti Drejtues Kombëtar		0	0
	Kryesia e Partisë		0	0
	Kryetari i partisë		0.17	0.17
	Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve		0.75	0.75
Vendimmarrja	Çështjet programore		0.33	0.33
	Rekrutimi		0.19	0.19

Për sa i përket Çështjeve Programore, LSI ka të njëjtin rezultat me PS dhe PD. Të tre partitë shënojnë 0.33 (me përjashtim të PS-së në statutin e 2020 ku vlera është 0.55), duke treguar kështu një përfshirje mesatare të anëtarëve të partisë në përgatitjen e programit të partisë. Kjo tregon nivel mesatar centralizimi.

Rekrutimi: Me nënkategorinë e rekrutimit synojmë të kuptojmë nivelin e përfshirjes së anëtarëve të partisë në emërimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë, zgjedhjen e anëtarëve për Këshillin Kombëtar dhe Kryesinë e partisë, si dhe procedurat e votimit dhe rolin e seksioneve në procesin e përzgjedhjes së individëve në poste publike dhe partiake (von dem Berge et al, 2013, f. 14-15) (shih Tabelën 14 më poshtë). Rezultatet tregojnë se anëtarësia ka më shumë të drejta për kandidatët për përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë dhe më pak për nominimin e tyre. Për sa i përket zgjedhjeve të lidërshiptit të partisë, anëtarët kanë pak (nëse asgjë) për të thënë. Vlerat e nënkategorive janë shumë të vogla. Për më tepër, dega nuk ka asnjë rol në zgjedhjen e kandidatëve të saj për partinë në poste publike dhe partiake. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve në qendër dhe në periferi (për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore) kontrollohet nga kryesia e partisë. Ky është tregues i një partie të centralizuar.

TABELA 15: VLERAT E DBP-SË PËR NËNKATEGORINË E NIVELIT 3 – LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

Viti	2012	2020		2012	2020
Nominimi/kandidimi i kandidatëve	0.33	0.33	Rekrutimi për poste publike kombëtare	0.38	0.38
Përzgjedhja e kandidatëve për deputet	0.6	0.6			
Roli i degëve	0.2	0.2			
Zgjedhja e Komitetit Drejtues Kombëtar	0.17	0.17	Rekrutimi për poste partiake në nivel kombëtar	0.12	0.12
Zgjedhja e Kryesisë	-0.20	-0.20			
Zgjedhja e kryetarit të partisë	0.4	0.4			

Viti	2012	2020		2012	2020
Procedurat e votimit	0.25	0.25	Procedurat	0.08	0.08
Roli i degëve (poste publike)	0	0			
Roli i degëve (poste partiake)	0	0			

4.3 Përfundime – Analiza përmbajtjesore

Indeksi i DBP-së tregoi se pavarësisht ndryshimeve të shumta që kanë pësuar statutet e partisë, ka ende shumë për të bërë. Ndonëse në përgjithësi partitë shënuan rezultate të mira për sa i përket të drejtave të anëtarësisë, përfshirë të drejtat e pakicave, ato patën rezultate të dobëta në procesin e vendimmarrjes dhe në strukturat organizative. Kështu, edhe pse anëtarët dhe zyrtarët e partisë i kushtojnë një rëndësi të madhe organizatës si mekanizëm për të siguruar përfshirjen e anëtarëve dhe decentralizimin e vendimmarrjes, në realitet dhe në letër, ka ende shumë për të bërë. Matja e indeksit të DBP-së është shumë e dobishme për vetë partitë politike. Kjo matje evidenton kategoritë dhe nënkategoritë që duhen përmirësuar, gjë prej së cilës do të përfitojnë të gjithë.

Tabela e mëposhtme na ndihmon të krahasojmë partitë me njëra-tjetrën dhe të shohim se cili dimension është më mirë se tjetri. Në këtë tabelë kemi nxjerrë të dhënat nga statuti i fundit që kemi pasur në dorë, sepse që nga aty nisnin rekomandimet për përmirësim. Në të tri partitë politike, decentralizimi është më mirë si nivel se gjithëpërfshirja. Të gjitha partitë duhet të përmirësohen në drejtim të kërkesës së llogarisë ndaj kryesisë. Kategoritë që janë zero ose bien nën zero, si: Emërimi i Kandidatëve (PS), Zgjedhja e Kryesisë (PS dhe PD), Kryesia (që mat llogaridhënien e Kryesisë ndaj kongresit të partisë) (veçanërisht për PD dhe LSI) dhe roli i seksioneve (për PD dhe LSI) duhet të trajtohet sa më shpejt të jetë e mundur.

TABELA 16: KRAHASIMI I GJITHËPËRFSHIRJES DHE DECENTRALIZIMIT TE PARTITË POLITIKE SHQIPTARE

Dimen- sioni	Nënkategoria	PS (2020)	PD (2021)	LSI (2021)
Gjithëpërfshirja	Të drejtat e përgjithshme të anëtarëve	0.83	0.17	1
	Të drejtat e pakicave	0.33	0.67	0.67
	Kongresi/Kuvendi i partisë	1	0.4	0.6
	Organet e zgjidhjes së konflikteve	0.5	0.5	0.5
	Asambleja/Këshilli/ Komiteti Drejtues Kombëtar	0.67	0	0
	Kryesia e partisë	0	0	0
	Kryetari i partisë	0.33	0.33	0.17
	Nominimi/kandidimi i kandidatëve	-0.33	0.17	0.33
	Përzgjedhja e kandidatëve për deputet	0.2	0.2	0.6
	Zgjedhja e Këshillit Kombëtar	0	0.2	0
	Zgjedhja e kryesisë	-0.2	-0.2	0
	Zgjedhja e kryetarit të partisë	0.4	0.4	0.17
	Procedurat e votimit	0.25	0.25	0.25
	Vlera mesatare e gjithëpërfshirjes	0.31	0.24	0.33
Decentralizimi	Kryetari i partisë	0.4	0.33	0.17
	Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve	0	0.75	0.75
	Emërimi i kandidatëve	-0.33	0.17	0.33
	Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve	0.2	0.2	0.6
	Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për poste drejtuese në pushtetin vendor	0.25	0	0
	Marrëdhëniet mes qendrës dhe degëve në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për poste drejtuese në degët e partisë	0.25	0	0
	Çështje programore	0.08	0.33	0.33
Vlera mesatare e decentralizimit	0.12	0.25	0.31	

4.4 Analizë teksti – Si e kuptojnë anëtarët e të gjitha niveleve DBP dhe si e lidhin atë me jetën e tyre organizative?

4.4.1 Analiza e intervistave

Në këtë pjesë të studimit do të shqyrtojmë diskursin e përdorur nga zyrtarë të lartë të partive në lidhje me DBP-në. Së pari dhe më kryesorja, DBP-ja është e lidhur fort me strukturën dhe organizimin e partisë. Organizimi i partisë është mekanizmi kryesor që siguron përfshirjen e anëtarëve në procesin e vendimmarrjes dhe decentralizimin e procesit të vendimmarrjes nga qendra në bazë në të gjitha nivelet partiake. Organizata e partisë mendohet si rrip transmisioni që dërgon dhe merr mesazhet, kanalizon mendimet, shqetësimet, sugjerimet dhe idetë nga radhët e anëtarësisë tek kryesia e partisë dhe anasjelltas, nga lart poshtë. Është kanali kryesor përmes të cilit kryesia e partisë mbledh mendime, ide dhe propozime nga anëtarët.

Tek PD, një nga të intervistuarit e lidhi performancën e dobët të partisë me institucionet e dobëta të saj. Sipas të intervistuarit, ekziston një problem i madh me demokracinë e brendshme të partive dhe me demokracinë në përgjithësi, sepse gjithçka është e lidhur me kryetarin e partisë. Një nga problemet më të mëdha të PD-së gjatë këtyre viteve që partia ka qenë në opozitë është dobësimi i institucioneve të partisë. Në vend të decentralizimit të pushtetit ndërmjet Kryetarit të Partisë, Konventës së Partisë, Këshillit Kombëtar dhe Kryesisë së Partisë, i gjithë pushteti ishte në duart e Kryetarit të Partisë. Kjo në një farë mënyre ka "vrrarë" demokracinë e brendshme, sepse ka shkatërruar të gjithë kanalet e komunikimit në parti, kanale që janë krijuar pikërisht për të decentralizuar pushtetin në nivele të ndryshme të partisë dhe për të përfshirë anëtarët në procesin e vendimmarrjes. Çdo anëtar i Kryesisë së Partisë, çdo anëtar i Këshillit Kombëtar ose i Kongresit të Partisë është përfaqësues i një grupi anëtarësh dhe kur pengohet e drejta e tyre për të folur, për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes, atëherë vullneti i atyre që i kanë deleguar pushtetin atij/asaj është anashkaluar dhe kështu demokracia e brendshme nuk funksionon. Vota e anëtarëve është themeli i demokracisë së partisë dhe në të njëjtën kohë është mekanizmi që forcon dhe vë në funksion institucionet e partisë. Struktura e organizatës është e një rëndësie të madhe. Është kanali që siguron komunikimin ndërmjet niveleve të ndryshme të partisë dhe në të njëjtën kohë është i vetmi mekanizëm që trajton konfliktet në parti.

Një tjetër model i përbashkët për të tri partitë politike ishte ekzistenca e fraksioneve. Në përgjithësi, fraksionet konsideroheshin të mira dhe të shëndetshme për partinë, sepse bëjnë të mundur që të dëgjohen të gjithë zërat dhe të mbrohen ata që kundërshtojnë qeverisjen e Kryetarit të Partisë. Veçanërisht në PD dhe LSI, qëndrimi ndaj fraksioneve ishte shumë pozitiv. LSI ishte shumë krenare për periudhën kur vendosi të legalizonte fraksionin e saj jashtë PS-së në vitin 2003. Një nga të intervistuarit e konsideroi këtë si periudhën kur partia ishte në kulmin e DBP-së. Ekzistenca e fraksioneve është e përcaktuar edhe në statutin e partisë që nga krijimi i partisë. Megjithatë, në gati dy dekada të jetës partiake, nuk ka pasur asnjëherë ndonjë fraksion brenda partisë. Në Partinë Demokratike, një pjesë e të intervistuarve u shprehën entuziaste për futjen e fraksioneve në statutin e ri të partisë. Aftësia për të thënë mendimin dhe për të mos u ndëshkuar për këtë konsiderohej e shëndetshme dhe e një rëndësie të madhe për të gjithë. Megjithatë, një pjesë e të intervistuarve të PD-së komentuan se fraksionet duhet të trajtohen me shumë kujdes, sepse mund të çojnë në krijimin e partive të reja, të cilat mund të dëmtojnë vetë partinë.

Një tjetër i intervistuar komentoi se DBP-ja ishte “mall luksi” dhe se partitë politike shqiptare nuk kanë qenë kurrë demokratike. Kodi Zgjedhor ka pasur pjesën e vet në këtë, sepse ka inkurajuar kryetarë autoritarë të partive, qëllimi i të cilëve ka qenë të forconin pozitat e tyre dhe të kontrollonin të gjithë partinë. Megjithatë, sipas intervistës, është më shumë se çështje e Kodit Zgjedhor. Ngjarjet e fundit, kur ish-drejtuessit e PD-së dhe LSI-së u kthyen sërish dhe rifituan drejtimin e partisë, mbështesin tezën se në Shqipëri partitë konsiderohen si pronë e kryetarit të partisë. Në këto lloj partish nuk lejohen diferencat në mendime. Nëse dikush del kundër udhëheqjes së partisë, ai/ajo ose largohet nga partia dhe krijon një parti të re ose mbetet jashtë politikës. Statuti nuk është i mjaftueshëm për të siguruar demokracinë e brendshme dhe për të krijuar një kulturë të DBP-së. Statusi është fasadë. Anëtarët janë të keqpërdorur dhe të mashtruar. Gjërat thuhën dhe bëhen në emër të anëtarëve, por interesat e anëtarëve nuk kanë qenë kurrë në fokus. Anëtarët trajtohen si numra dhe jo si individë me vlera dhe kontribute që japin për partinë. Statuti i partisë është hartuar nga kryetari i partisë në mënyrë të atillë që ta mbrojë atë në çdo situatë. Ngjarjet e fundit në PD⁴ treguan se statuti i ri i partisë miratohet para tubimeve masive (kuvendeve apo kongreseve) prej 3,000-



4 Duke iu referuar miratimit të Statutit të ri të PD-së në prill 2022 nga ana e “Foltres” të Sali Berishës.

4,000 anëtarësh, të cilët thjesht miratojnë atë që u lexohet pa pasur diskutime dhe konsultime paraprake. Statuti është në dorën e kryetarit të partisë, i cili e interpreton sipas dëshirës dhe në dobi të tij. Është përdorur në konfliktet e brendshme partiake për t'i shërbyer interesave të pozicioneve të ndryshme të pushtetit brenda partisë. Demokracia e brendshme nuk është çështje statuti, rregullash dhe procedurash, por është çështje vullneti. Vetëm kur liderët politikë do të kenë vullnetin për t'i shndërruar partitë politike në organizata demokratike, atëherë do të arrihet demokracia e brendshme në parti.

Për sa i përket mundësive për të bërë karrierë brenda strukturës së partive, të intervistuarit ishin dakord se është e mundur, por nuk ndodh shpesh. Përbërja e Kuvendit të Shqipërisë, ku ka plot raste të individëve që nuk kanë arsimin e duhur, që nuk dinë të artikulojnë problemet dhe të propozojnë zgjidhje, të cilët janë të inkriminuar në veprimtari të ndryshme të paligjshme, është tregues se të bësh karrierë në sajë të meritave dhe kontributit në radhët e partisë ndodh rrallë. Megjithatë, një i intervistuar pohoi se në partitë autoritare, anëtarët asgjësohen – thënë në mënyrë metaforike. Ata nuk kultivojnë udhëheqës dhe është e pamundur të bësh karrierë politike në parti. Nëse dikush është i talentuar dhe ka guxim dhe energji për t'u bërë udhëheqës, ai/ajo shtypet dhe përjashtohet nga partia, sepse perceptohet si kërcënim për kryetarin e partisë.

Të intervistuarit pranuan rëndësinë e sistemit zgjedhor dhe implikimet që ai sjell në demokracinë e brendshme të partive, edhe pse jo të gjithë ranë dakord që sistemi zgjedhor është faktor përcaktues për DBP-në. Një pjesë e tyre zgjodhën sistemin zgjedhor mazhoritar, sepse lidhja mes anëtarëve të partisë dhe kandidatit për deputet është më e fortë. Ndryshimi i Kodit Zgjedhor nga mazhoritar i përzier në proporcional rajonal ka ndikuar në tipologjinë e kandidatëve për deputetë. Në sistemin miks mazhoritar me proporcional kandidatët ishin më të përgatitur, ishin të suksesshëm në profesionet e tyre dhe kishin lidhje të mira me bazën e partisë. Ndryshimi i sistemit zgjedhor pati implikime edhe në profilin e kandidatëve.⁵ Partitë tani nuk janë më parti me personalitete të njohura, por janë kthyer në parti kryetarësh. Prandaj, sistemi mazhoritar u konsiderua si një opsion shumë i mirë. Në këtë



5 Edhe pse zgjedhjet e vitit 2021 u organizuan me sistemin zgjedhor të përfaqësimit proporcional me listë të hapur, sipas të intervistuarve, sistemi nuk ishte i hapur, por gjysmë i mbyllur apo gjysmë i hapur, sepse, me pak përjashtime, ata që ishin në pjesën e sigurt të lista ishin ata që u zgjodhën.

sistem, mendimet dhe sugjerimet e anëtarëve të partisë në një zonë të caktuar zgjedhore janë të rëndësishme dhe merren seriozisht, sepse miratimi i anëtarëve është vendimtar për suksesin e kandidatit. Për të intervistuarit e tjerë, nuk është sistemi zgjedhor, por janë rregullat dhe rregulloret e partisë, ato që ndikojnë në nivelin e DBP-së.

Prezantimi i primareve në zgjedhjet e të gjitha forumeve partiake në PD u pa si shenjë e demokratizimit të partisë. Në të vërtetë, të intervistuarit shprehën shumë entuziazëm dhe i konsideruan këto primare si një kurë që do të ofronte zgjidhje për të gjitha problemet me të cilat është ndeshur partia deri tani. Ata i konsideronin primaret si mekanizëm që do të fuqizonte anëtarët dhe do t'u bënte të mundur të emëronin kandidatët më të mirë. Po ashtu, primaret konsiderohen si një mekanizëm me potencial për të promovuar brenda partisë ata anëtarë që duan të ecin përpara dhe të jenë në gjendje të gjejnë mbështetje të mjaftueshme nga anëtarët e tjerë të partisë.

Të intervistuarit ranë dakord se ruajtja e demokracisë së brendshme në parti ka koston e vet, e cila nganjëherë bëhet barrë për vetë partinë, veçanërisht kur financimet nga shteti janë të pamjaftueshme. Megjithatë, pavarësisht nga barra financiare, ia vllente të ruheshin lidhjet me anëtarët dhe nëpërmjet tyre me elektoratin dhe komunitetin në përgjithësi, sepse vetëm në këtë mënyrë partia do të ishte më pranë nevojave dhe shqetësimeve të qytetarëve.

Vendosja e kuotave për gratë dhe të rinjtë, si në rastin e LSI-së, u konsiderua si një mekanizëm për përmirësimin e demokracisë së brendshme të partisë. Për ta, sa më përfaqësuese të ishin forumet partiake, aq më demokratike ishte partia.

4.4.2 Analiza e grupeve të fokusuara – Perceptimet e anëtarëve për demokracinë e brendshme

Rezultatet e grupeve të fokusuara – Partia Socialiste

Të intervistuarit e grupeve të fokusuara tek PS e lidhin DBP-në me nivelin e përfshirjes në procesin e vendimmarrjes dhe aftësinë për të shprehur mendimin dhe për të pasur dhe ushtruar të drejtat e veta. Liria e fjalës dhe e drejta për të shprehur mendimin pa u penalizuar ishin fjalët e përmendura nga pjesëmarrësit. Kur dikush pyetet për mendimin e tij/saj dhe nuk penalizohet për mendime që janë të ndryshme nga ato të kryetarit, kjo gjë konsiderohej demokratike. Një mjedis që i bën të

mundur anëtarëve të mbështesin njëri-tjetrin konsiderohet demokratik. Demokracia forcohet mes njerëzve që ndajnë të njëjtat vlera. Ekzistenca e opinioneve të ndryshme është karakteristikë e Partisë Socialiste. E drejta e votës ishte një tjetër koncept i lidhur me DBP-në. Së fundi, DBP u lidh me mundësinë për të bërë karrierë brenda strukturave të brendshme të partisë.

Për sa i përket mekanizmave të parashikuar në statutin e partisë, të intervistuarit përmendën parimin “një anëtar, një votë”. Procesi përdoret në të gjitha zgjedhjet që zhvillohen në organizatë, nga njësia më e vogël organizative (organizata socialiste) deri tek ajo kryesore për zgjedhjen e kryetarit të partisë, si dhe në zgjedhjet që zhvillohen në forumin e grave. Statuti u konsiderua si një dokument i rëndësishëm, të cilit anëtarët duhet t’i referohen për organizimin e jetës së përditshme të partisë, përfshirë këtu zgjedhjen e kryetarit të partisë, aplikimin e kuorumit për zgjedhjen e kryetarëve të degëve të partisë dhe kushtin që kandidatët alternativë të konkurrojnë për çdo pozicion, në mënyrë që votimi të marrë rëndësinë e duhur. Hierarkia partiake u konsiderua thelbësore për ruajtjen e DBP-së brenda partisë. Sipas pjesëmarrësve të grupeve të fokusuara, struktura hierarkike ishte e dobishme për të kanalizuar idetë, shqetësimet, sugjerimet, propozimet e anëtarëve dhe gjithçka që ata dëshironin në lidhje me procesin e vendimmarrjes në parti. Së fundi, anketat me anëtarët e partisë për çështje të ndryshme janë një tjetër mekanizëm që udhëheqja e partisë përdor për të mbledhur opinionet e tyre për të siguruar më vonë mbështetjen e anëtarësisë.

Struktura organizative u konsiderua e rëndësishme dhe u identifikua si një mekanizëm shumë i mirë për të ndarë pushtetin nga lart poshtë dhe për të mbledhur ide nga poshtë lart. Megjithatë, pjesëmarrësit nga seksioni i të rinjve mendonin se mungesa e një forumi rinor në vendi ka pakësuar mundësitë që zëri i tyre të dëgjohet qartë. Një organizatë kombëtare që mbledh ide, sugjerime dhe propozime nga zona të ndryshme të vendit është shumë më e fuqishme se shumë organizata rinore të shpërndara në të gjithë territorin, të cilat mund të sjellin zërin e tyre vetëm te drejtuesit e degës në nivel qarku, por jo më tutje. Disa pjesëmarrës menduan se organizata herë pas here “abuzohej” nga delegatë të fuqishëm, të cilët kanë lidhje më të ngushta me deputetin e zonës dhe ushtrojnë më shumë ndikim tek ai, duke lënë mënjanë delegatët e tjerë. Prandaj, struktura hierarkike, ndonëse ka rëndësinë e vet, nuk e shpërndan gjithmonë pushtetin në mënyrë të barabartë nga lart poshtë.

Të intervistuarit e grupeve të fokusuara e lidhën DBP-në edhe me ekspertizën. Mundësia për të sjellë në parti ekspertë nga fusha të

ndryshme të jetës publike u konsiderua një qasje integruese që e bënte partinë më demokratike. Zërat nga sferat e akademisë dhe shoqërisë civile u konsideruan të rëndësishëm dhe një mjet për të diversifikuar opinionet në radhët e anëtarësisë. Për më tepër, përfaqësues nga shoqëria civile apo qarqet akademike mund të japin kontributin e tyre në parti pa qenë domosdoshmërisht anëtarë të saj. Kështu, vija ndarëse midis anëtarëve dhe simpatizantëve është deri diku e paqartë, duke humbur kështu fuqinë e anëtarëve të thjeshtë. Grupet e fokusuara e panë këtë mungesë të vijës ndarëse si një gjë pozitive, pasi sipas tyre kjo rrit grupin e mbështetësve të partisë, thith ekspertizë nga jashtë saj dhe forcon lidhjen e partisë me elektoratin në përgjithësi.

Për sa i përket rolit që luan statuti në mbujtjen e frymës së demokracisë brenda partisë, herë pas here pjesëmarrësit e ngatërronin atë me rolin e tij në organizimin e jetës së partisë. Edhe pse shumë e rëndësishme për jetën e partisë, shembujt e dhënë nuk ishin gjithmonë tregues i DBP-së. Për shembull, pjesëmarrësit sollën si shembull se si i janë referuar statutit për përcaktimin e numrit të delegatëve në kongresin e partisë.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë analizohet shumë shpesh për të kuptuar fuqinë e anëtarësisë së thjeshtë përballë drejtuesve të nivelit të lartë. Në pyetjen nëse janë pyetur për këtë, përgjigjet kanë qenë të ndryshme. Disa pretenduan se lista është hartuar në përputhje me propozimet dhe marrëveshjen e anëtarëve në bazë. Në përgjithësi, kandidatët e propozuar ishin individë që kishin karriera solide politike dhe për rrjedhojë ishin të njohur dhe gëzonin mbështetjen e njerëzve në bazë. Duke iu referuar sistemit zgjedhor proporcional, pjesëmarrësit pohuan se renditja e kandidatëve në listë nuk ishte e rëndësishme, pasi në fund u zgjodhën vetëm ata që kishin mbështetjen e anëtarëve të partisë. Për të ilustruar argumentin u soll shembulli i numrit të 34 në listën e Tiranës⁶ në zgjedhjet e përgjithshme të 2021. Edhe pse thuajse në fund të listës së kandidatëve, kandidati sërish arriti të zgjidhej për shkak të numrit të lartë të votave që mori, gjë që mundësohet me një sistem i hapur zgjedhor proporcional rajonal. Sipas të intervistuarve, ata që u zgjodhën ia dolën në këtë drejtim, sepse kanë punuar më shumë.

Megjithatë, disa pjesëmarrës menduan se nuk ishin pyetur për përbërjen e listës së kandidatëve për deputetë. Të rinjtë ndiheshin veçanërisht



6 Orinaldo Rakipi mori 15,697 vota, duke u renditur i dyti në listën e Tiranës për numrin e votave të marra. Edhe pse fillimisht ishte i 34-ti në listën e kandidatëve të Tiranës për deputet, rezultati e lejoi të ishte pjesë e listës fituese.

të përjashtuar nga ky proces. Ata mendonin se që një parti të jetë demokratike, është e nevojshme të lejohen të dëgjoen të gjithë zërat dhe praktika që janë përdorur me gratë duhet të përdoren edhe me të rinjtë. Ata mendonin se mund të jepnin një kontribut më të mirë për partinë nëse u bëhej e mundur të përparonin drejt niveleve më të larta të saj. Të rinjtë nuk ishin të kënaqur me nivelin e përfaqësimit në parlament dhe mendonin se ky përfaqësim mund të ishte më i mirë. Përfaqësimi i mirë i të rinjve në nivel vendor erdhi si rezultat i mundësisë që pati PS për të hartuar lista të gjata këshilltarësh për shkak të mospjesëmarrjes së partive opozitare në zgjedhje, gjë që i dha mundësinë PS-së të plotësonte të gjitha vendet e këshillit bashkiak me anëtarë nga PS. Pra nuk erdhi si pasojë e mekanizmave të vetë partisë, por si rezultat momental, i cili nuk do të përsëritej sërish, sepse, në zgjedhjet e tjera lokale, për shkak të procesit normal të pjesëmarrjes në zgjedhje edhe të partive të tjera, Partia Socialiste nuk do të kishte mundësi të kishte kaq shumë këshilltarë.

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara iu referuan nismës “Deputeti që duam”⁷ si mjet për të marrë mendime nga baza e partisë. Kjo u interpretua si shenjë e një niveli të lartë të DBP-së brenda partisë. Platforma dixhitale u përmend si një tjetër mekanizëm që partia përdor për të mbledhur opinione nga baza dhe për të forcuar zërat dhe rolin e anëtarësisë. Megjithatë, pjesëmarrësit ishin dakord se lista përfundimtare e kandidatëve për deputetë është rezultat i propozimeve nga terreni, por në të njëjtën kohë fjalën e fundit e ka kryetari i partisë. Duke qenë se ai zgjidhet nga anëtarët e partisë, ai ka edhe të drejtën të marrë vendime.

Pjesëmarrësit ishin dakord se disa nga kandidatët për deputetë nuk ishin anëtarë të partisë, por ishin njerëz të profilit të lartë që vinin nga sfera të tjera të jetës publike si qarqet akademike apo shoqëria civile. Ata e konsideruan këtë një shenjë të hapjes së partisë, sepse në këtë mënyrë partia ishte në gjendje të zgjeronte grupin e ‘rekrutimit’ dhe të forconte lidhjet e saj me elektoratin dhe shoqërinë në përgjithësi. Duke pranuar rëndësinë e bërjes së karrierës brenda strukturave të partisë, ata e vlerësuan të nevojshme të sillnin në parti edhe të ardhur, njerëz me ekspertizë në fusha të ndryshme të jetës publike, të cilët nuk kanë qenë



7 Në tetor 2020, kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama ndërmori nismën “Deputeti që duam”, e cila ishte një ftesë për të gjithë ata që donin të provonin veten në fushën e vështirë të politikës dhe të avancin kandidaturën e tij/saj për zgjedhjet e përgjithshme të 2021 nën siglën e PS-së..

asnjëherë pjesë e PS-së, sepse vetëm në këtë mënyrë partia do të merrte ekspertë, njerëz me kontribut në komunitet dhe të forconte lidhjet e saj me shoqërinë.

Për sa i përket kanaleve të përdorura për të kuptuar opinionet, mendimet, idetë dhe propozimet nga anëtarët e thjeshtë, përveç mekanizmave të përmendur më sipër (platforma dixhitale, “deputeti që duam”) grupet e fokusuara treguan se partia organizon seanca dëgjimore, takime të shpeshta me anëtarët në organizatat bazë. Strukturat e partisë funksionojnë si një rrip transmisioni që kalojnë mesazhin nga poshtë lart. Anëtarët e thjeshtë pyeten ose për qëllime organizative dhe/ose për politika dhe strategji. Njësitë më të vogla shërbejnë edhe për lidhjen e shoqërisë me partinë. Jeta me njerëzit në përditshmërinë e tyre ofron mundësinë për të kuptuar problemet e tyre dhe për t’i transmetuar ato në nivelet më të larta të organizatës së partisë për të gjetur zgjidhjen e duhur. Kjo bëhej në mënyrë periodike, duke lidhur kështu komunitetin me drejtuesit e nivelit të mesëm dhe të lartë të partisë.

Përsa i përket pyetjes nëse ia vlente të shpenzonin një pjesë të kohës si vullnetarë për partinë, pjesëmarrësit komentuan se e kanë bërë me dëshirë dhe e kanë parë të nevojshme. Anëtarët u shprehën se pavarësisht kostos financiare që kërkonte jeta partiake, ia vlente të ‘investohej’ në të.

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara mendonin se mund të kishin një karrierë në strukturën organizative të partisë, e cila u konsiderua si shenjë e DBP-së. Edhe gratë mendonin se mund të bënin karrierë dhe të promovoheshin brenda partisë, gjë që konsiderohej edhe kjo si tregues i DBP-së. Kuotat për gratë e kanë bërë më të lehtë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes së partisë. Statuti parashikon që çdo njësi organizative e partisë të drejtohet nga një burrë dhe një grua. Kjo fuqizon gratë dhe rrit shanset e tyre për të shkuar më lart në nivelet më të larta të partisë. Të rinjtë socialistë mendonin se ishte e mundur të bënin karrierë edhe pse nuk ishin të kënaqur me të ‘katapultuarit’ nga jashtë partisë, me ata që kanë marrë poste të mira në parti dhe në qeveri, pa punuar për partinë.

Për sa i përket vendimmarrjes, pjesëmarrësit ranë dakord se DBP nuk ishte domosdoshmërisht përfitimi përfundimtar. Në raste emergjence, drejtuesit e partisë, të zgjedhur nga anëtarësia, kishin autoritetin të merrnin vendime pa u konsultuar me anëtarët e thjeshtë. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për emërimin e kryetarëve të organizatave në rrethe, poste që mbetën bosh dhe nuk kishte kohë për të organizuar

rizgjedhje, veçanërisht në çastet e zgjedhjeve parlamentare apo vendore ku përpjekjet e partisë janë të fokusuar në fushatën elektorale dhe preferohet që të përqendrohen të gjitha përpjekjet duke punuar me komunitetin për rezultatin më të mirë të mundshëm në zgjedhje.

Primaret u konsideruan nga disa prej të intervistuarve si mekanizëm demokratik që forcon rolin e anëtarësisë. Megjithatë, disa mendonin se primaret mund të rrisin fuqinë e kryetarit në dëm të drejtuesve të nivelit të mesëm. Kjo përkon me atë që Katz dhe Mair (1995) kanë theksuar se sa më shumë të drejta që u jepen anëtarëve aq më shumë autonomi për drejtuesit e partisë, veçanërisht nga radhët e nivelit të mesëm të partisë.

Fraksionet brenda partisë nuk shiheshin si diçka pozitive. Të intervistuarit e kishin shumë të qartë se ekzistenca e fraksioneve është tregues i DBP-së dhe se njerëzit duhet të kenë lirinë e mendimit dhe nuk duhet të penalizohen për këtë nëse mendimi i tyre bie ndesh me atë të kreut të partisë. Megjithatë, fraksionet nuk konsideroheshin të mira, madje më shumë të dëmshme për partinë. U komentua se fraksioni bie ndesh me atë që parashikohet në statutin e partisë. Për ta ilustruar këtë, ata sollën shembullin e LSI-së, e cila u krijua si parti e shkëputur nga PS. Megjithatë, gjatë shprehjes së mendimeve të tyre për fraksionet dhe mendimet e ndryshme brenda partisë, pjesëmarrësit ndjenin nevojën për të shtuar mbiemrin “të mira”. Kështu, ata po flisnin për “fraksione të mira” apo “mendime të mira të ndryshme”, pa specifikuar qartë se si do të gjykohej për “mirësinë” ose jo të këtyre opinioneve të ndryshme. Të intervistuarit përmendën kritere shumë të paqarta, si “një opinion i cili ka mbështetje të qëndrueshme dhe është i ndërtuar mirë”, por këto nuk janë kritere të qarta, pasi i takon liderit të partisë të përcaktojë nëse një argument ka prova të pakundërshtueshme dhe është i ndërtuar mirë. Kur flisnin për ‘fraksione të mira’, pjesëmarrësit komentonin se njerëzit e kuptojnë në një farë mënyre kur fraksionet kanë qëllime të mira apo të këqija. Kur fraksioni apo kritika nuk i drejtohet kryeministrit, apo një ministri të caktuar, por fokusohet në një problem specifik, atëherë ky konsiderohet një fraksion i mirë. Dikush që kritikon por qëndron në parti konsiderohej më i mirë se dikush që largohet nga partia për të kritikuar, sepse motivet e kritikës mund të lidhen me problemet personale me udhëheqjen e partisë dhe jo shqetësimin e vërtetë për të.

Pati pjesëmarrës që mendonin se nëse demokracia është e mirë në nivel makro, atëherë duhet të jetë e mirë edhe në nivel mikro. Pra, një parti duhet të ketë demokraci të brendshme. Sipas tyre, edhe në grupin më të vogël nuk është e mundur që të gjithë të kenë të njëjtin mendim. Prandaj, në një parti të madhe, siç është PS, është e vërtetë

që njerëzit kanë mendime të ndryshme dhe si të tillë duhet të jenë të lirë t'i shprehin ato. Disa pjesëmarrës mendonin se partia nuk është marrë mirë me fraksionet brenda partisë. Sa herë që dikush ka dalë kundër vullnetit të kryetarit të partisë, ai/ajo është lënë mënjanë. Kjo është përsëritur edhe në nivelet e ulëta të partisë ku ka pasur raste kur dikush ka shprehur një mendim të ndryshëm nga kryetari i seksionit/degës/njesisë, ai ose ajo është përjashtuar nga mbledhja. Pjesëmarrësit ishin shumë të kujdesshëm kur komentonin fraksionet. Ata e mbajtën diskutimin në nivel sipërfaqësor, duke folur kryesisht hipotetikusht, por nuk pranuan të jepnin mendime për ngjarje konkrete.

Për disa nga pjesëmarrësit, madhësia e partisë kishte implikimet e saj për nivelin e demokracisë së brendshme. Disa argumentuan se implikimet ishin pozitive por disa mendonin se kishte edhe negative. Të qenit parti e madhe shihej si një tregues i hapjes së partisë. Sa më e madhe të jetë partia, aq më i madh është grupi i opinionëve që ka, dhe kështu aq më demokratike bëhet. Megjithatë, pjesëmarrësit e tjerë komentuan se madhësia është e rëndësishme: në partitë e vogla, anëtarët kanë lidhje më të mira me udhëheqjen e partisë dhe sa më e madhe të bëhet partia, aq më shumë shtohen nivelet hierarkike ndërmjet anëtarëve të thjeshtë dhe udhëheqjes së partisë. Megjithatë, ata e panë të nevojshme, sepse menaxhimi i një partie të madhe kërkon më shumë përpjekje dhe më shumë njerëz sesa një parti e vogël. Pavarësisht kësaj, ata u siguruan të konfirmonin se ishin të bindur se edhe pse struktura e partisë ishte komplekse me shumë nivele të ndërmjetme drejtuesisht, zëri i tyre gjithsesi dëgjohej dhe idetë e tyre çoheshin në nivelet më të larta të partisë.

Sistemi zgjedhor u konsiderua si faktor që ndikon në DBP. Të intervistuarit mendonin se roli i tyre u rrit ndjeshëm në zgjedhjet e fundit. Votimi për kandidatët me lista të hapura u dha më shumë pushtet anëtarëve të partisë dhe kështu udhëheqja e partisë u detyrua të konsultohet me ta për të siguruar besnikërinë dhe mbështetjen e tyre gjatë zgjedhjeve. Në këtë sistem, anëtarët mendonin se kishin më shumë liri për të zgjedhur mes kandidatëve për deputetë. Pavarësisht mbështetjes për mekanizmat e përdorur nga partia për nominimin e kandidatëve dhe renditjen e tyre në listat partiake, ata gjithsesi shprehën shqetësimin se procesi nuk ishte plotësisht i hapur. Fakti që u zgjodhën ata që u vendosën në krye të listës u konsiderua si tregues se listat ishin gjysmë të hapura dhe jo plotësisht të hapura, gjë që tregon se anëtarësia ka një pushtet të reduktuar. Edhe pse mund të duken deklarata kontradiktore, kjo ka ardhur si rezultat i dinamikave brenda grupeve të fokusuar, ku secili prej pjesëmarrësve, përveçse shprehte mendimin e

tij, kontrollonte edhe përgjigjet e të tjerëve për t'u siguruar që partia të dilte sa më mirë. Kështu, ankesat mbeteshin në formë deklaratash të shkurtara pa u sqaruar në mënyrë më të detajuar.

Një pjesë e të intervistuarve nuk e lidhte të qenët parti në opozitë apo parti në pushtet me nivelin e DBP-së. Partia kishte demokraci në të dyja rastet: zgjedhjet brenda partisë organizoheshin në të njëjtën mënyrë dhe zërat dhe opinionet dëgjoeshin me të njëjtën vëmendje. Megjithatë, disa pjesëmarrës të grupeve të fokusuara mendonin se zëri i anëtarëve të thjeshtë dëgjohej më shumë kur partia ishte në opozitë. Sipas tyre, kur një parti është në opozitë, shkalla e solidaritetit mes anëtarëve të partisë është më e lartë dhe kryesia e partisë i kushton më shumë vëmendje anëtarëve të saj.

Rezultatet e grupeve të fokusuara– Partia Demokratike

Të intervistuarit e grupit të fokusuar mendonin se një parti ka demokraci të brendshme kur ajo ofron një hapësirë për të prodhuar ide edhe kur këto ide kundërshtojnë njëra-tjetrën; kur ofron një hapësirë për të bërë kritika, që stimulon ide dhe opinione të ndryshme dhe kur vendimmarrja është transparente. Për ta, një parti me demokraci të brendshme u ofron mundësi grave dhe të rinjve që të kenë një zë të fortë në procesin e vendimmarrjes dhe të kenë një përfaqësim të mirë në udhëheqjen e partisë. Pjesëmarrësit shprehën mendimin se partia i shfaq tiparet e saj demokratike kur ofron mundësinë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, kur zbaton parimin “një anëtar, një votë” dhe kur anëtarët ofrojnë mbështetje për njëri-tjetrin. Ata mendonin se një parti me demokraci të brendshme është një vend ku anëtarët kanë lirinë e shprehjes dhe respektojnë mendimet e njëri-tjetrit, ku promovimi i njerëzve është i bazuar në merita dhe votimi për udhëheqjen e partisë është i lirë dhe i pavarur.⁸

Struktura organizative shihet si një mekanizëm që ndihmon për të siguruar demokracinë e partisë. Ata e mendojnë partinë si një piramidë ku procesi i vendimmarrjes përfshin të gjithë strukturat e partisë dhe shpërndahet në të gjitha nivelet e piramidës. Për ta nuk duhej që vendimet të merreshin pa u konsultuar me anëtarësinë në bazë. Statuti i partisë u konsiderua si një mekanizëm shumë i mirë që mundëson



8 Kjo është si e kuptojnë ata demokracinë e brendshme në përgjithësi dhe jo atë të Partisë Demokratike në veçanti.

integrimin e të gjitha niveleve partiake në procesin e vendimmarrjes dhe vëmendje e madhe duhet t'i kushtohet zbatimit të tij. Statuti u konsiderua si kushtetuta e partisë.

Mundësia për të bërë karrierë brenda strukturës organizative të partisë u pa edhe si shenjë e demokracisë së brendshme të saj. Ndërkohë që në lidhje me PD-në, të intervistuarit ranë dakord se përfshirja e tyre në aktivitetet e partisë nuk ishte më e mira dhe ishte më e vogël në krahasim me partitë e tjera kryesore politike në Shqipëri. Të intervistuarit shprehën shqetësimin se anëtarët jo gjithmonë i dinë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre dhe edhe kur në mbledhjet e partisë shpreheshin mendime të ndryshme, kjo ishte më shumë rezultat i lobimit dhe përkatësisë në "klane" të ndryshme brenda partisë sesa shprehje personale e ideve dhe qëndrimeve. Ata e mendonin si të nevojshme që anëtarët të edukohen në mënyrë që t'i referohen statutit të partisë gjatë organizimit dhe zbatimit të veprimtarisë së partisë. Megjithatë, ata u shprehën optimistë se gjërat do të shkonin më mirë, sepse primaret ishin prezantuar në statutin e partisë dhe kjo u konsiderua si shenjë shumë e mirë për demokracinë e brendshme dhe për vetë partinë.

Kur u pyetën nëse e njihnin statutin e partisë, ata thanë se e njohin dhe kanë votuar për ndryshimet e tij, sa herë që janë bërë ato. Statuti në përgjithësi nuk ndryshon shumë. Sipas pjesëmarrësve të grupeve të fokusuar, rreth 90% e tij mbetet i njëjtë dhe çdo herë prezantohen përmirësime të reja. Por, pjesëmarrësit shprehën shqetësimin se statuti nuk është zbatuar gjithmonë në praktikë. Për shembull, edhe pse statuti parashikon që gratë të kenë 30% të posteve drejtuese në parti, kjo ende nuk ka ndodhur.

Të intervistuarit i referoheshin shumë shpesh organizimit të primareve si një mekanizëm shumë i mirë i parashikuar në statutin e ri të partisë për të garantuar demokracinë e brendshme. E drejta për të propozuar kandidatë për deputetë konsiderohej si tregues i nivelit më të lartë të demokracisë në parti. Ndër ndryshimet e tjera që u prezantuan janë zgjedhja e kryetarit të partisë, sekretarëve të degëve të partisë, rritja e numrit të sekretariateve, të cilat synojnë rritjen e rolit të anëtarëve në organizimin dhe funksionimin e partisë. Megjithatë, ata kanë theksuar se statuti i mëparshëm nuk ishte i keq. Sipas tyre, aty u shkruan shumë gjëra të mira, por që nuk u zbatuan. Një nga të intervistuarit komentoi: "Në Shqipëri është çështje vullneti. Parimet janë universale. Ato nuk janë shpikur nga ne. Zgjedhja e strukturave, e delegatëve, sistemi i votimit "një anëtar, një votë"...të gjitha ishin aty, në statut. Por ishte çështje vullneti për ta zbatuar atë." Sipas tyre, statuti i dikurshëm ka parashikuar

shumë gjëra për të garantuar demokracinë në parti, si parimi “një anëtar, një votë” dhe aplikimi i parimit të meritokracisë, por nuk janë zbatuar. Zgjedhjet e fundit për Këshillin Kombëtar në qershor 2021, pas humbjes së zgjedhjeve të përgjithshme, ishin një farsë. Listat dhe gjithçka tjetër ishin përgatitur paraprakisht dhe anëtarët nuk e kishin thënë fjalën e tyre.

Kur u pyetën nëse i janë referuar ndonjëherë statutit për zgjidhjen e konflikteve të brendshme, ata komentuan se në përgjithësi konfliktet dhe mosmarrëveshjet janë zgjidhur me mirëkuptim mes anëtarëve dhe nuk ka qenë e nevojshme referimi në statut. Gjithsesi, për aktivitetet e përditshme në parti dhe për procese të tjera të rëndësishme, ata shpesh i janë referuar statutit në mënyrë që të kuptojnë se si duheshin organizuar aktivitetet dhe eventet. Megjithatë, të pranishmit pranuan se i ishin referuar më së shumti statutit kur shqetësimet e ngritura ishin në nivel vendor dhe jo në partinë në qendër.

Të intervistuarit theksuan vazhdimisht dallimin para dhe pas zgjedhjeve partiake të 25 prillit 2022.⁹ Zgjedhjet e fundit i dhanë më shumë pushtet anëtarëve. Në të kaluarën, anëtarët pyeteshin për mendimin e tyre, por në fund nuk merrej shumë në konsideratë, sepse vendimmarrja nuk bazohej në mendimin e tyre. Ata theksuan rëndësinë e primareve si një risi që do të forconte demokracinë e brendshme në parti. Rinovimi i kartave të anëtarësisë u konsiderua edhe si një mekanizëm për të forcuar lidhjet e partisë në qendër me atë në bazë. Një tjetër risi e statutit të ri¹⁰ është zgjedhja e kreut të degës duke zbatuar parimin “një anëtar, një votë”.

Të pyetur nëse u ishte marrë mendimi për përgatitjen listave me kandidatë për deputetë, të intervistuarit e grupeve të fokusuara u përgjigjën se përgatitja e listave ka qenë një proces me tre hapa. Në fazën e parë, degët në bazë propozonin emrat e kandidatëve. Në fazën e dytë, një komision filtronte kandidatët e propozuar dhe përgatiste listat e përzgjedhura, të cilat më pas iu prezantoheshin sërish anëtarëve që të



9 Fokus grupet u zhvilluan në ambientet e Partisë Demokratike e cila ishte nën kontrollin e grupit ‘Foltore’ të PD-së (Sali Berisha). Ndaj pjesëmarrësit ishin pothuajse unanimitisht kritikë ndaj periudhës që partia drejtohej nga ish kryetari i PD, Lulzim Basha.

10 Pjesëmarrësit iu referuan statutit të ri të miratuar në Konventën e prillit 2022. Megjithatë, statuti i ri nuk ishte finalizuar ende kur u mbledhën grupet e fokusuara dhe madje edhe më vonë. Anëtarët ishin në dijeni të primareve dhe të gjitha pikave të tjera që lidhen me DBP nga diskutimet në media dhe takimet e partisë si dhe sepse statuti iu lexua anëtarëve të PD-së që morën pjesë në konventën e PD-së.

votonin për kandidatin më pak të preferuar. Kjo ka shkaktuar probleme, sepse ka pasur jo pak raste kur ata që kanë votuar e kanë keqkuptuar procesin, duke votuar për kandidatin e tyre të preferuar. Prandaj, grupet e fokusuara shprehën idenë se për të pasur demokraci të brendshme, rregullat që u japin pushtet anëtarëve duhet të jenë të lehta për t'u kuptuar dhe zbatuar. Në fund gjithsesi, nuk u morën parasysh propozimet e anëtarëve të thjeshtë. Pra, sipas pjesëmarrësve, pati një proces, por në fund gjithsesi propozimet e tyre nuk u morën parasysh.

Kur u pyetën nëse kanë pasur mundësinë të ndikojnë në përbërjen dhe renditjen e kandidatëve për deputetë në listat e partive, të intervistuarit u përgjigjën se edhe pse janë pyetur, listat përfundimtare kanë qenë surprizë edhe për ta, çka nënkuptonte se anëtarësia nuk kishte thënë fjalën e saj në atë proces, pavarësisht rregullave dhe rregulloreve të përcaktuara në statutin e partisë. Procesi u cilësua si një farsë, si një shfaqje. Roli i anëtarëve nuk ka qenë thelbësor edhe në përzgjedhjen e kreut të degës. Ka pasur raste kur kreu i degës është zgjedhur pa konkurrencën e nevojshme, duke qenë kandidati i vetëm në garë. Kjo u theksua si diçka që ka dëmtuar rëndë demokracinë e brendshme të partisë.

Gjatë diskutimeve, të intervistuarit iu referuan edhe mekanizmave të përdorur nga partia për të mbledhur opinionet e tyre. Pavarësisht nëse janë marrë në konsideratë idetë dhe sugjerimet e tyre, mekanizmat kanë qenë aty dhe madje janë përdorur. Krahas transmetimit të ideve dhe opinionëve përmes zinxhirit të strukturave të partisë, kjo e fundit ka pasur drejtori të ndryshme, secila prej të cilave fokusohet në çështje të veçanta, si ekonomia dhe financat, çështjet sociale, shëndetësia, etj. Ky konfigurim ishte i ngjashëm si në qendër ashtu dhe në degët në bazë. Sondazhet, tryezat e rrumbullakëta dhe takimet me studentë të shkëlqyer, grupe interesi dhe komunitete të marginalizuara ishin mekanizma të tjerë që përdorshin nga partia për të mbledhur mendimet dhe sugjerimet e anëtarëve të saj dhe të komunitetit në përgjithësi. Megjithatë, këto takime kanë qenë më të shpeshta në kohë zgjedhjesh dhe nuk kanë qenë mekanizma të përhershëm. Të intervistuarit u shprehën se nëse takime të tilla do të bëheshin rregullisht, partia do t'i kishte fituar zgjedhjet, sepse do ta dinte më mirë se çfarë kërkon populli.

Mundësia për të bërë karrierë brenda strukturave partiake u konsiderua si tregues i demokracisë së brendshme. Kanë qenë të shumtë ata që kanë arritur në majat e partisë për kontributin dhe përkushtimin e tyre. Futja e primareve u konsiderua si diçka që do ta përmirësonte këtë

proces, duke rritur mundësitë që njerëzit të zgjidheshin nga baza dhe jo në mënyrë arbitrare nga kryetari i partisë.

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusuara shprehën idenë se ishte më e lehtë t'i shprehnin lirisht idetë e tyre në degët e partisë në bazë sesa në qendër. Kështu, partia ishte më demokratike në bazë sesa në qendër. Pjesëmarrëset e forumit të grave, veçanërisht, theksuan se forumi është më demokratik se vetë partia dhe i ka mbështetur më shumë se qendra.

Pjesëmarrësit e konsideruan demokracinë e brendshme si shumë të rëndësishme dhe që duhej të zbatohet me çdo kusht. Rezultatet e zgjedhjeve treguan se nëse nuk konsultohen me anëtarët, atëherë është e vështirë të fitohen zgjedhjet, veçanërisht kur partia në pushtet i ka manipuluar zgjedhjet në favor të saj. Sipas tyre, partia nuk ka nevojë për militantë të thjeshtë; përkundrazi, ajo duhet të kanalizojë burimet e saj njerëzore në mënyrë që të mund të merret më e mira nga të gjithë. Të intervistuarit u shprehën se edhe në raste emergjencash nuk duhet anashkaluar demokracia e brendshme. Cilësia e vendimmarrjes ishte më e rëndësishme sesa emergjenca e dukshme e situatës. Këtë e kanë treguar edhe ngjarjet e fundit.¹¹ Anëtarët kanë treguar gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në mbledhjet e partisë edhe kur ato mbaheshin në orën 22.00. Pra, urgjenca nuk justifikon anashkalimin e hapave të parashikuar në statutin e partisë për procesin e vendimmarrjes.

Për sa i përket fraksioneve, ashtu siç e kuptojnë pjesëmarrësit e fokus grupeve, fraksionet nuk duhet të kuptohen si grupe antagoniste, por si grupe që kanë mendime të ndryshme. Fraksionet ishin një gjë e mirë, sepse ato pasqyrojnë mendimet e ndryshme në parti dhe këto mendime duhen dëgjuar dhe respektuar. Statuti i ri pranonte krijimin e fraksioneve të reja brenda partisë dhe se për të pasur një fraksion në parti, grupi duhet të përbëhet nga të paktën 15 persona.

Shpenzimet financiare për sigurimin e demokracisë në parti u konsideruan të nevojshme. Pavarësisht nga kostot e nevojshme për të kryer të gjitha procedurat e duhura të përmendura në statutin e partisë dhe aplikimi i mekanizmave të tjerë për mbledhjen e opinionëve nga baza, siç u përmend më lart, demokracia e brendshme në parti ishte më e rëndësishme se këto kosto. Një nga pjesëmarrësit komentoi: "Aspekti më i rëndësishëm i demokracisë së brendshme në parti është e drejta për vendimmarrje. Pavarësisht se sa e kushtueshme mund të jetë, kjo



11 Pjesëmarrësit përdorën shpesh shprehjen "ngjarjet e fundit" duke iu referuar ndarjes së partisë në dy pjesë në vitin 2021, pas humbjes së zgjedhjeve.

pikë është shumë e rëndësishme. Partia duhet t'i mbajë afër anëtarët e saj." Po ashtu, pjesëmarrësit theksuan se ia vlente që të jepnin nga koha e tyre për të siguruar demokracinë në parti.

Rezultatet e grupeve të fokusuara – Lëvizja Socialiste për Integrim

Kur u pyetën se si e kuptojnë konceptin e demokracisë së brendshme në parti, anëtarët e lidhën atë me koncepte të tilla si “një anëtar, një votë”, pjesëmarrje aktive në hartimin e dokumenteve kryesore të partisë, si statuti apo programet zgjedhore, liria e anëtarëve të partisë, edhe në njësitë më të vogla, për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre dhe liria për të debatuar për çështje të ndryshme të rëndësishme partiake, qofshin edhe ato që lidhen me programin apo strategjinë e partisë. Partia konsiderohej prej tyre si një organizatë e njerëzve që miratojnë një sërë rregullash (statutin e partisë) në bazë të të cilave partia zhvillon aktivitetet e saj të përditshme. Sa më mirë të respektohen këto rregulla, aq më mirë është e organizuar partia dhe aq më të përgjegjshëm janë anëtarët e saj. Ndjekja e rregullave të vendosura në statutin e partisë ishte e lidhur fort me thelbin e demokracisë së partisë. Anëtarët mendonin se vetëm kur të gjithë, nga anëtari më i thjeshtë e deri te nivelet më të larta të partisë, i kanë të qartë detyrat e tyre, partia mund të ketë demokraci të brendshme. Zgjedhjet partiake të vitit 2015 të organizuara me parimin “një anëtar, një votë” ku vota u hodh në mënyrë elektronike, mori vlerësime të veçanta dhe u pa si shprehje e demokracisë së brendshme. Janë vlerësuar edhe zgjedhjet e vitit 2020 të mbajtura gjatë pandemisë: edhe ato u zhvilluan në mënyrë elektronike dhe anonime për të garantuar legjitimitetin e organeve të zgjedhura. Edhe pse u mbajtën në kohë të vështira, ato u konsideruan të nevojshme dhe u organizuan në përputhje me rregullat dhe rregulloret e statudit të partisë.

Pjesëmarrëset nga forumi i grave e lidhën demokracinë e brendshme me mbështetjen që anëtarët duhet t'i ofrojnë njëri-tjetrit për të siguruar gjithëpërfshirje të të gjithëve. Sipas tyre, një parti me demokraci të brendshme është jetike për demokracinë e vendit. Në një parti demokratike, anëtarët ndihen të vlerësuar, konkurrojnë për poste të ndryshme brenda partisë dhe paraqesin kandidaturën e tyre për zgjedhjet vendore dhe parlamentare.

Madhësia e partisë u soll edhe si faktor që ndikon në nivelin e demokracisë së brendshme në parti. Duke qenë se kjo parti është e vogël, të paktën krahasuar me PS-në dhe PD-në, anëtarët e thjeshtë dhe

drejtuesit kanë një lidhje të ngushtë dhe komunikim shumë të mirë me njëri-tjetrin gjë që mundëson lirinë e shprehjes dhe hapjen. Hierarkia dhe burokracia nuk janë të konsoliduara dhe anëtarët e thjeshtë mund të komunikojnë lehtësisht me kreun e partisë. Megjithatë, pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e rregullave për të gjithë. Kur respektohet statuti, atëherë madhësia nuk ka rëndësi, sepse demokracia në parti mund të ekzistojë vetëm kur rregullat respektohen dhe zbatohen nga të gjithë në parti. E drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në poste të ndryshme në parti shihej edhe si shprehje e demokracisë së brendshme.¹²

Të gjithë të intervistuarit iu referuan statutit të partisë, duke treguar kështu se e njihnin dhe e pranonin atë. Statuti u citua shumë shpesh gjatë gjithë diskutimit si pikënisje dhe mbërritje për të gjitha vendimet e marra brenda partisë. Statuti i partisë ka mbetur pothuajse i njëjtë që nga hartimi i tij në vitin 2003, me pak ndryshime.

Kur u pyetën për mekanizmin e parashikuar për të instaluar dhe ruajtur frymën e demokracisë në udhëheqjen e partisë, të intervistuarit iu referuan parimit “një anëtar, një votë”, kuotat e vendosura për të rinjtë dhe gratë¹³, dhe të drejtën për të shprehur lirshëm mendimin e tyre edhe kur ky opinion bie ndesh me pozicionimin e kryesisë së partisë, të drejtën për të zgjedhur delegatët në kuvend, për të zgjedhur drejtuesin e seksioneve dhe të drejtën për të qenë pjesë e strukturave partiake. Struktura dhe organizimi i partisë dhe forumeve u perceptuan si një mekanizëm që siguron demokracinë e saj të brendshme. Shpërndarja e pushtetit mes kreut të partisë, nënkryetarit, nënkryetarëve, sekretarëve përgjegjës për fusha të ndryshme, Komitetit Drejtues Kombëtar, Konventës së Partisë, madje edhe degëve dhe nëndegëve të partisë, siguron që të dëgjohet zëri i të gjithëve. Përzgjedhja e delegatëve për kuvendin e partisë organizohet në nivel vendor. Komiteti Drejtues Kombëtar zgjidhet nga delegatët sipas parimit “një anëtar, një votë”. Të intervistuarit ishin të vetëdijshëm se vendimet e partisë duhet të merreshin në mënyrë kolegjiale dhe se ekzistenca e fraksioneve ishte e sanksionuar në dokumentet e partisë. Kolegjialiteti në procesin e vendimmarrjes dhe përcaktimi për të drejtën e fraksioneve dhe shprehjes së mendimeve të ndryshme konsideroheshin si tregues të tjerë të demokracisë në parti.



12 Pjesëmarrësit e fokus grupeve folën në terma të përgjithshme në nivel teorik. Ata u bënë konkretë vetëm kur përshkruanin përvoja personale.

13 Fokus grupet theksuan se gratë përbëjnë 50% të listave partiake për zgjedhjet parlamentare.

Intervistat nxorën në pah se pjesëmarrësit ishin pyetur dhe kishin propozuar ata që përfaqësojnë strukturat e partisë në Komitetin Drejtues Kombëtar dhe se në fakt propozimet e tyre ishin marrë parasysh dhe kjo ishte e vërtetë edhe për organizatën e grave.

Për sa i përket procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë, të intervistuarit ishin dakord se edhe pse janë pyetur dhe konsultuar për listën përfundimtare, propozimi i tyre për renditjen e kandidatëve në listat e partisë nuk është marrë gjithmonë parasysh për shkak të numrit të kufizuar të atyre që do të zgjidheshin. Kryesia e partisë ka një fjalë të rëndësishme në përgatitjen e listave të kandidatëve. Megjithatë, liria e kryesisë së partisë nuk është e pakufishme dhe ndikon në një farë mase vetëm në renditjen e kandidatëve dhe jo në përbërjen e plotë të listës. Prandaj, mendimi i anëtarëve të partisë në bazë është i rëndësishëm, duke qenë se kandidatët për deputetë kanë nevojë për anëtarët e të gjitha niveleve për të organizuar fushatën zgjedhore. Përgatitja e listës finalizohet pas diskutimeve mes anëtarëve dhe kryesisë së partisë.

